

SHABAN DEMIRAJ

EMRAT PREJFOLJORË ASNJANËS DHE TOGJET ME VLERË FOLJORE TË FORMUARA ME PJESËMARRJEN E TYRE.

1. Emrat prejfoljorë asnjanes dhe togjet me vlerë foljore të formuara me pjesëmarrjen e tyre, siç do të vihet në dukje edhe gjatë këtij artikulli, kanë tërhequr vëmendjen e mjaft gjuhëtarëve shqiptarë e të huaj, duke qenë se paraqisin një sërë problemesh të vështira si në planin diakronik ashtu edhe në planin sinkronik. Disa nga këto probleme janë bërë objekt shqyrtimi edhe në këtë artikull, i cili është ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë, si trajtohen origjina e emrave prejfoljorë asnjanes të tipit të *folur-i-t* dhe përmbajtja semantike e tyre, bëhet fjalë edhe për përkatësinë kategoriale të tyre në shqipen e sotme. Kurse në pjesën e dytë trajtohen togjet me vlerë foljore të tipit *për të punuar, me të ardhur dhe një të ardhur*. Si argumentohet përkatësia kategoriale e këtyre togjeve dhe si vihen në dukje vlerat e tyre funksionale, shqyrtohet mënyra e formimit të tyre, duke pasur parasysh edhe togjet e ngjashme me vlerë foljore të disa gjuhëve të tjera të Ballkanit. Për të vërtetuar lashtësinë e dukurive të shqyrtuara në këtë artikull, shembujt ilustrues janë marrë jo vetëm nga shqipja e sotme por edhe nga gjuha e autorëvet tanë të vjetër.

I

EMRAT PREJFOLJORË ASNJANËS.

2. Gjallëria relative e gjinisë asnjanesë në gjuhën shqipe është e lidhur ngushtë me ekzistencën e emrave prejfoljorë asnjanes të tipit të *folurit, të ngrënë, të* që janë emërtuar në mënyra të ndryshme prej autorësh të ndryshëm. Ata janë karakterizuar si *pjesore të substantivuarra*¹, *pjesore të përdorura si paskajore të substantivuara*,² *asnjanes të pjesores*³, *asnjanes të mbiemrit pjesor*⁴, *paskajore të substantivuara*⁵,

1) Cimochowski, 29 («participe substantivé»); Domi, *Morfologjia hist.* 5, («Pjesore e substantivuar»); Çabej, *BUSHT*, 1, 1962, 95 («participi i substantivuar të fikët...»); Sheperi, 35 («Emërat e nyjshëm të prejardhurë nga përdorimi... i pjesorevet si emëra»).

2) Meyer, *Grammatik*, 8 («die als substantivische Infinitive verwendeten Participia»); Pedersen, *KZ* 34, 285. (si Meyer-i).

3) Camarda, 188 («i neutri sostantivi derivati dai participi»), Pekmezi, 105 («das Neutrum des Participi»); Domi, *Sintaksa*, 214 («me asnjanesin... të pjesores»).

4) Sheperi, 84 («me asjatëroren e mbiemrit pjesor»).

5) S. Frashëri *Shkronjëtoje*, 6 («E paçquemja kur përdoretë si emër), Xanoni, 21 («Kuer viin [emrat e gjinisë asnjanesë — Sh.D.] prej t'pasoseve»); Brincuş, *SCL*, 1, 1963, 77, («infinitiv substantivat»).

emra foljorë⁶, emra foljorë asnjane⁷, mbiemra foljorë asnjane të substantivuar⁸ dhe emra prejparticiporë të veprimit.⁹

Edhe vetë këto emërtime të ndryshme flasin qartë për pikëpamjet e ndryshme të gjuhëtarëve lidhur me këtë klasë emrash, të cilët si përnga struktura ashtu edhe përnga kuptimi paraqisin një sërë problemesh të vështira për t'u zgjidhur: Si janë krijuar emrat e këtij tipi dhe me cilën temë foljore duhen lidhur? Ç'lidhje e ç'dallim kanë nga mbiemrat foljorë të tipit *i, e bërë, i, e ngrënë, i, e folur* si edhe nga emrat prejfoljorë të mërorë të tipit *e ngrënë-a* (geg. *e hangme-e* hangmja)? Që kur është shfaqur kjo klasë emrash në gjuhën shqipe dhe si duhet interpretuar nga pozitat e shqipes së sotme?

Zgjidhja e këtyre problemeve është e lidhur ngushtë me sqarimin e disa çështjeve të tjera gjithashtu shumë të vështira të gramatikës historike të gjuhës shqipe, siç janë çështja e moshës së nyjeve të përparme dhe ajo e paskajores, që edhe sot e gjithë ditën mbeten *sub iudice*.

3. Tema e emrave prejfoljorë asnjane (pa nyjen e përparme) në përgjithësi përkon me atë të pjesores së shkuar pësore. Ky përkim është i plotë në toskërishte. P.sh. të krahasohen pjesoret e shkuara *zënë, mbjellë, folur* etj. me emrat prejfoljorë asnjane të *zënë-t, të mbjellë-t, të folur-it* etj. Përsa i takon gegërishtes së sotme, përkimi është i plotë, kur tema e pjesores dhe e emrit prejfoljor asnjane përgjegjës mbaron me *-në*. P.sh. të krahasohen pjesoret e shkuara *zanë, lanë, qenë* me emrat prejfoljorë asnjane të *zanë-t fill, të lanë-t, të qenë-t*. Por, kur pjesorja del me temë në zanore të theksuar, përkatësisht në togjet e zanoreve *-ue, -ye, -ie*, ose në *-ë* të patheksuar, tema e emrit prejfoljor asnjane përgjegjës del në *-m*, përkatësisht *-un*. P.sh. të krahasohen pjesoret e shkuara *la, ble, fshi, shkrua, lye, ndie, hapë* etj. me emrat prejfoljorë asnjane të *lam-it, të llem-it, të fshim-it, të shkruem-it, të lyem-it, të ndiem-it, të hapun-it* etj. Ndryshe paraqitet gjendja tek autorët gegë të shekujve XVI-XVII, tek të cilët pjesoret e foljeve me temë në zanore, përkatësisht në togje zanoresh, madje edhe pjesoret që në gegërishten e sotme dalin me *-ë* të patheksuar, përdoren pothuaj rregullisht me prapashtesën *-m¹⁰*, përkatësisht *-unë*, e tek Buzuku edhe me prapashtesat *-në, -të¹¹*. Sa për ilustrim, po rendisim këtu disa shembëlla nga Buzuku dhe nga Bogdani:

6) Reinhold, Gr. 5 (τὰ ἐπιματικά ὀνόματα); Dozon, 208 («Noms verbaux»); Sandfeld, 130 («substantif verbal»); Lambertz, *Lehrgang*, Teil III, 74 («Verbalsubstantiva aus substantivierten Partizipien»); Sp. Floqi, BUSHT, SSHSH, 3, 1958, 116 («e emrit foljor»); kurse në f. 115 «emri prejfoljor».

7) Cipo, *Gramatika*, 121 («...e emrave foljorë asnjane»); Xhuvani, St. Gjuh., 209 («... e emrit foljor asnjane»), Demiraj, *Morfologjia* (dispensë), 248, («emrat foljorë të gjinisë asnjane»).

8) Kostallari, BSHSH, 4, 1955, 24.

9) Gabinski, 57 v.

10) Pjesoren me prapashtesën *-m* duhet ta ketë pasur edhe toskërishtja. Për këtë dëshmojnë gjurmët e saja jo të paka tek arbëreshët e Italisë (P.sh. Matrënga: *E mbsuame*; Fila: *bekuam*) si edhe në të folme të Jugut (p.sh. në çamërishte: Kroji ishte *mërguam*; në Gjirokastrë, sipas një kumtimi të E. Çabejt, *ditë e lëvruame*; kurse i *mënuam*, i *shënuam*, i *qëruam*, që gjejmë tek Kavallioti, ndofta janë trajta të sajuara nën ndikimin geg.).

11) Për format e pjesores së shkuar dhe të emrave prejfoljorë asnjane tek Buzuku shih E. Lafe, P. Gj. B., 154-160. Aty, në f. 158-160, jepet edhe një listë foljesh, që në pjesore dalin me forma të ndryshme, si 1) *dëm, danë, datë*; 2) *lëm, lanë, lätë*;

Buzuku:

-në: kleshë *zanë* (165/b), të *zanë-të* (7/a); ansh të *lenë* (8/a), (për) të *lenë-t...* (20/b); ish *klenë*. (5/a), të *klenë-të* (92/a) etj.

-m: të jetë *bekuom* (97/a), të *bekuom-i-të* (9/a); tue *him* (39/b), të *him-i-të* (4/a) etj.

-unë: të jetë *ardhunë* (14/b), *t ardhun-i-të* (37/b): kini *gjegjunë* (127/b), nde e *gjegjunë* (81/a) etj.

-ë: pat *folë* (24/a), të *folë* (70/a); kle *bdjerë* (56/b), të *bdjerë-të* (33/a) etj.

-të: ansh të *përvutë* (135/a), të *përvutë-të* (92/b), ish *thatë të thatë-të*.

Bogdani (nga pjesa I e veprës):

-në: është *zanë* (I/III/58); të *zanë-të* (I/IV/49).

-m: qi **!** ka gjithë *krijuem* (I/I/5), të *krijuem-i-të* (I/VI/1); nukë është *lem* (I/I/5); të *lem-i-të* (I/IV/37).

-unë: të jetë *mbajtunë* (I/III/10), të *mbajtun-i-të* (I/IV/17); ka me *ardhunë* (I/III/20), me *t'ardhun-i-të* (I/III/19).

-ë: ka *mbëledhë*¹² (I/III/13), të *mbëledhë* (I/VI/1).

Pra, edhe në gegërishte në një fazë më të vjetër ka pasur një përkim pothuaj të plotë midis temave të pjesorevet, nga njëra anë, dhe tema- vet të emrave prejfoljorë asnjanes, nga ana tjetër.

Përsa u takon emrave asnjanes të *ftohtë-t*, të *ngrohtë-t*, të *nxehtë-t*, të *thatë-t*, tek të cilët tema del me prapashtesën *-të*, këta në shqipen e sotme (madje edhe tek autorët e vjetër) e kanë shumë të zbehur kuptimin foljor, prandaj duhen interpretuar si emra prejmbiemërorë asnjanes¹³.

* * *

Kur përdoren në numrin shumë, emrat prejfoljorë asnjanes marrin mbaresat *-a* dhe *e*, që, siç e kemi vënë në dukje edhe më parë¹⁴, në origjinë nuk kanë qenë të gjinisë asnjanesë, po të gjinisë femërore. Marrin mbaresën *-a* emrat prejfoljorë asnjanes të tipit të *zënë*, të *mbjellë*, të *lidhun* (tosk. të *lidhur*) dhe të *përvutë*. P.sh. Përse u mos madhështonem **!** këso së *panash..* «Et ne magnitudo revelationum extollat me...»; ...se të korrëtë taj të nglatetë djerie **!** së *vjelash* e të vjelëtë djerin **!** së *mbjellash*.¹⁵

Kurse emrat prejfoljorë asnjanes, që kanë prapashtesën *-m*, si të *bām*, të *shkruem* etj., e formojnë shumësin me mbaresën *-e*. P.sh.

3) *lëm*, *lenë*, *lëtë* etj. Por do pasur parasysh se emrat prejfoljorë asnjanes në raste të tilla zakonisht dalin me nga një formë të vetme, p.sh. të *dëtë* (183/b), mbë të *lanë-t* (30/b), (të parëtë) e *lenë* (69/a) etj.

12) Por në I/IV/37 Bogdani shkruan: *mbëledhunë*.

13) Të kihet parasysh se si emra veprimi në gjuhën shqipe përdoren emrat prejfoljorë asnjanes të *fthohur*, të *ngrohur*, të *nxehur*, të *tharë* (geg. të *fthohun*, të *ngrohun*, të *nxehun*, të *tham*).

14) Shih artikullin tonë *Rreth mbaresave të shumësit të emrave asnjanes në gjuhën shqipe*, «Stud. fil.», 2, 1968, 142-144.

15) Buzuku, 49/b (ad Corinthios, II. 12/7); 188. Edhe tek Matrënga gjejmë: të *përzëna*, «prosecutione», të *dhëmburat* «le pene», të *sharatë* «le ingiurie», të *taksurat* «le promissioni», shih C₁, 42, 18², 45, 25.

E aj tue pasunë njohunë të kujtuometë e tyne, tha: «Ipse autem ut vidit cogitationes eorum dixit eis:».

Bani të mira udhëtë tuoj e të bametë tuoj «Bonas facite vias vestras, et studia vestra»; ... Përse n zemeret dalënë të kujtuometë e këqia... të dëshmuometë e rëshime, të truometë. «De corde enim exeunt cogitationes malae... falsa testimonia, blasphemiae.»¹⁶

4. Për anën kuptimore vlen të theksohet se emrat prejfoljorë asnjanes shënojnë kryesisht veprime abstrakte ose gjendje, por më ndonjë rast edhe rezultate veprimi.¹⁷ Kuptimi i tyre në përgjithësi nuk largohet nga ai i foljevet përgjegjëse¹⁸. Kur folja përgjegjëse është intransitive ose e diatezës mesore, emri prejfoljor asnjanes ka gjithashtu kuptim intransitiv. Por, kur folja përgjegjëse (në trajtën veprorë) është transitive, atëhere emri prejfoljor asnjanes mund të përdoret, sipas rrethanave, me kuptim 1) vepror, 2) vetëvetor e madje edhe 3) pësor. Kur përdoret me kuptim vepror, ai mund të marrë edhe kundrinë (të drejtë e të zhdrejtë) si edhe plotës rrethanorë kohe e vendi si edhe plotës mënyre etj.

Me kuptim intransitiv përdoren emra prejfoljorë asnjanes të tillë si të ardhur, të ecur, të dalë, të hyrë, të shkuar etj. (ashtu si foljet përgjegjëse vij, eci, dal, hyj, shkoj etj.). P.sh. ...N së dalët së diellët¹⁹. («A solis ortu...»)... e kshtu mbasi të kienë mallëkuom gjithë sã gjymtyrë ... e të dalëtë e të himitë e të votëtë e t ardhunitë...²⁰; ...s'donin të shihnin lotët e njëri tjetrit, që të mos i merrte të qarët...; ... Vita me Llazin e morën këtë «të qëndruar mbi kokë» si detyrë të tij...²¹

Kuptim mesor kanë të tillë emra prejfoljorë asnjanes si të afruar, të ankuar, të druajtur, të zemëruar, të kthyer, të dëshpëruar etj. kur përdoren me kuptimet e foljevet përgjegjëse afrohem, ankoem, druhem, zemërohem, kthehem, dëshpërohem etj. P.sh. ... e t afëruomitë tat ata në përherë na kloftë për ndimë...²² ... sã i helmuomi cë dëshpëryemi mã s dij qish me bãm tjetër...²³ Kur merrte fund të kolliturit, u vinte radha kambanave...; ... që kishte dalë pak si tepër nga të ngjiturit e fustanit për trup.²⁴

Me kuptim vepror përdoren të gjithë ata emra prejfoljorë asnjanes, që janë formuar prej foljes transitive veprorë, si të bërë, të larë, të marrë, të ngrënë, të pirë etj etj. P.sh. e të marrët korp...; se ajo uratë... munë quhetë të qëllunë dhunë...; ... e të bāmītë misherier përmbi gjithata ...²⁵; ... vënë këmbë t'i ndalojnë nga të shkruarët gjuhën e tyre. ... tyrku ndaloi të hapuritë shkolla shqip...; ... po nukë ndaluanë dot shqipëtarët nga të mësuarëtë shkronjatë shqip. Një shtypëtore e qeverisë do të meretë me të shtypurë livratë...²⁶ Nga të dhënë e trupit, atje tek

16) Buzuku, 70/b (Luka, 11/17); 141/b (ad Galatas, 5/16; 74/a (Math. 15/19). Edhe tek Matrënga: të bëme të mira «buone opere» (C₁ 29).

17) P.sh. të pëgërët si (tek Xoxa, III/171) përdoret sot pothuaj vetëm me kuptimin e një rezultati konkret veprimi. Edhe emri prejfoljor asnjanes të vjellë përdoret më fort për të treguar rezultat veprimi.

18) Por ka raste që kuptimi i emrit prejfoljor asnjanes është larguar pak a shumë nga kuptimi i foljes përgjegjëse, si p.sh. emri të lyer (geg. të lyen), që përdoret gjithashtu me një kuptim konkret lënde.

19) Buzuku, 4/a (Psalmus 112/3).

20) Budi, DC, 141.

21) Xoxa, I/252, 112.

22) Buzuku, 81/a.

23) Budi, D C, 121.

24) Xoxa, I/101; II/116.

25) Budi, D C, 10, 168, 99.

shkau e dash ra, një degë mani u tund...; ... dhe Xoxi i dha një të *goditur* lehtë mullaqes. Të *ngushëlluarit* është gjëja më e vështirë për njeriun, ashtu siç është të *uruarit* puna më e lehtë. Pilos iu frytën damarët nga të *përmbajturit* e veches dhe nofullat zunë t'i blaujnë njëra tjetrën²⁷.

Disa emra prejfoljorë asnjane kanë, sipas kontekstit, herë kuptim vepror, herë kuptim jovepror (kryesisht intransitiv-mesor). Këta emra prejfoljorë janë formuar prej foljesh transitive, që përdoren si në diatezën veprorë ashtu edhe në diatezat e tjera, ose prej foljesh që përdoren edhe si transitive edhe si intransitive. Të tillë janë, ndër të tjerë, emrat prejfoljorë asnjane të *afruar*, të *ftohur*, të *hedhur*, të *hequr*, të *menduar*, të *ngrohur*, të *veshur*, të *zemëruar* etj. Për këtë qëllim të krahasohen këto dy shembëlla:

Sania, ... vërviti prapa krahëve, me një të *hedhur* të kokës, gërshetat e gjata... Sikur të kishin të kremte atë ditë Veli bej Vërdhoma me të tijtë e jo Shpiragajt, ai e mori rrugën për në Grizë duke kënduar, pirë e bërë xurxull, siç dukej edhe nga avazi që ai kish marrë si dhe nga të *hedhurit* mbi shalë, hedhje që nuk pajtoheshin me trokun e kafshës²⁸.

Të përdorurit e emrave prejfoljorë asnjane me kuptim herë vepror herë jovepror haset më dendur në togjet e ngurosura me vlerë foljore të tipit *me të afruar* dhe *një të afruar*²⁹ si edhe në togfjalëshat gjysëm të lirë të tipit *mbarova së rruari*³⁰.

Kurse në togfjalëshin e formuar nga folja *marr* dhe një emër prejfoljor asnjane i gjithë togfjalëshi ka një kuptim, që mund të shprehet edhe me diatezën mesore të foljes përgjegjëse të emrit prejfoljor asnjane. P.sh. *Qelqi ka marrë të krisur* është e barasvlershme me (Qelqi) *është krisur* (më saktë: *ka nisur të kriset*).

5. Në gjuhët e pajisura me nyje shquese prepozitive si gjuhët neolatine perëndimore, gjermanishtja, anglishtja etj. emrat prejfoljorë të këtij tipi formohen rregullisht nga tema e paskajores. P.sh. it. *il levar del sole*; fr. *le lever du soleil*; gjerm. *das Essen, das Schreiben* etj.

Madje edhe në greqishten e re, megjithëse paskajorja është zhdukur prej kohësh, mbijetojnë ende disa emra prejfoljorë asnjane të formuar nga tema e paskajores, si p.sh. nëpër tabela: *ἀπογορεύεται τό πύειν; ἀπογορεύεται τό καπνίζειν*³¹

[= Ndalohet të pështyurit; ndalohet të pirët duhan].

Por do pasur parasysh se në gjuhën rumune, e cila, siç dihet, ka mjaft konkordanca me shqipen në strukturën gramatikore, emrat prejfoljorë të këtij tipi formohen nga një formë gramatikore, që gjuhëtarët rumunë zakonisht e quajnë «supin»³², kurse disa gjuhëtarë të tjerë, sidomos jorumunë si Pankrasi³³, Taliavini³⁴, Sandfeldi³⁵, nuk e pranojnë si të saktë

26) S. Frashëri, Shqipëria, 46, 48, 49, 77.

27) Xoxa, III/84, 171; II/163, 238.

28) Xoxa, I/45; III/12.

29) Shih § 11-14.

30) Për këtë tip togfjalëshi shih vërejtjet tona në «Stud. fil.» 1, 1969., 113 v.

31) Shih Maria Moser — Philtsou, *Lehrbuch der Neugriechischen Volkssprache*, 137.

32) Shih GLR, I, 59, 232. Me sa duket, gjuhëtarët rumunë shohin në këtë «supin» refleksin e supinit latin të tipit *cantatum, perditum*, i cili është zhdukur që nga fillimi i periudhës imperiale të Romës. Për këtë shih, ndër të tjera, I L R, I, 190, ku shtohet: «Ndërmjet gjuhëve romane duket se vetëm rumanishtja e ka ruajtur supinin vetëm në rolin e emrit foljor, por ia ka zgjëruar shumë sferën e përdorimit.»

33) Shih B A, I, 107 v.

këtë term, pasi, sipas tyre, në këtë rast kemi të bëjmë me një formë participore. Siç shënon Pankraci³⁶, në rumanishte nga çdo folje, «mund të formohet një emër në formë participore». Në këtë pikë rumanishtja përkon me shqipen, ku gjithashtu nga çdo folje potencialisht mund të formohet një emër prejfoljor asnjans. Ashtu si në shqipe, edhe në rumanishte emrat prejfoljorë të këtij tipi, kur folja përgjegjëse është transitive, mund të përdoren jo vetëm me kuptim vepror, por edhe me kuptim vetëvetor e pësor. P.sh., sipas Pankracit³⁷, *măritat* «të martuar», *măcinat* «të bluar» etj. kanë kuptim vepror edhe pësor. Ashtu si në shqipe, edhe në rumanishte emrat prejfoljorë të këtij tipi, kur kanë kuptim vepror dhe janë në trajtë të pashquar, mund të marrin edhe ndonjë kundrinë të drejtë, si p.sh. *cules struguri* «të vjelë rrush» etj.³⁸ Por, ndryshe nga emrat prejfoljorë asnjans të shqipes, emrat prejfoljorë të këtij tipi në rumanishte, kur janë në trajtë të shquar, nuk mund të marrin ndonjë kundrinë të drejtë; ata mund të marrin vetëm plotës kundrinorë në rasën gjindore. P.sh. *culesul strugurilor*, [= të vjelët e rrushit³⁹]. Gjithashtu do pasur parasysh edhe fakti se si në shqipe ashtu edhe në rumanishte emrat e këtij tipi në shumës shoqërohen me mbiemra të gjinisë femërore⁴⁰. P.sh.: *Mă ndër këto të rrëfyeme të shkurtëna e të shpesha* mejaft mbaston. . . for [t] tue u ruojtunë ndër ato të pyetuna; . . . pā shumë të tjera të përziena. . .⁴¹; . . . për këto të lāme të pakora. . . : «di queste superflue lotioni»; aqā sa gramatika ndë këto të përzieme ntreti si krypa nd'ujët⁴². U lëshua dhe . . . e mbuloi kokën e shatores në të puthura të zjarrta. Në Shënepremtë, buzë kënete, u dëgjuan të qeshura të gjata⁴³. Pa mbaruar Hysejni fjalën, . . . krisnë njëra pas tjetrës një numur bombash dore dhe, menjëherë pas tyre, të shtira të vazhduara automatikësh. Troku i këpucëve të rënda mbi asfalt i përzihet me të rrahurat e forta, që filloi të ndjente në zemër e në tëmtha⁴⁴.

6. Konkordanca shqiptare-rumune në lidhje me emrat prejfoljorë në shqyrtim shkon edhe më tutje⁴⁵. Në të dy gjuhët me pjesëmarrjen e tyre janë formuar edhe togje të gramatikalizuara me vlerë foljore, që përd-

34) Shih Tagliavini, *Grammatica*, 310-311. Këtu Tagliavini shënon se edhe Meyer-Lübke në Rom. Gr. III, § 255, si edhe në *Geschichte des Infinitivs im Rumänischen* (në *Abhandlungen Herrn Prof. Dr. A. Tobler.* . .), 109-110. nuk e pranon terminin supin për rumanishten.

35) *Linguistique Balkanique*, 130.

36) BA, I, 131.

37) *Po aty*, 132.

38) *Po aty*, 132. Pancratz-i, duke cituar Blg. Gr. të Weigand-it, § 27, 49, shton se një ndërtim i tillë haset edhe në bullgarishte me emrat prejfoljorë të formuar me prapshitesën -anie, -enie, që, edhe kur kanë nyjen e sprasme shquese, kanë mundësi të marrin një kundrinë të drejtë; p.sh. za izutšvaneto vsitški balkanski jezici «për mësimin e të gjitha gjuhëvet ballkanike».

39) Shih Pancratz, BA, I, 133.

40) Për rumanishten shih G L R, I, 59, ku emrat në fjalë klasifikohen si asnjans, d.m.th. emrat që në njëjës paraqiten si mashkullorë e në shumës si femërorë.

41) Budi, SC, 58; RR, 58, 52.

42) Bogdani, pj. II, II/IV/18; f. 3 e Parathënies.

43) Xoxa, I/254; II/83

44) Musaraj, Para, I/241-2: II/397. Do pasur parasysh se në shqipen e sotme, kur ndjenja e gjinisë asnjansë është dobësuar shumë, format e tipit të qeshura, të rrëfyeme kuptohen zakonisht si forma shumësi të njëjësit femëror e qeshur, e rrëfyeme.

45) Për këtë shih, ndër të tjerë, Sandfeld, 130-132; Pancratz, BA, I, 147; Jokl, «Litteris», IV 203; Çabej, RRL 1-3, 1965, 107-108.

ren kryesisht me kuptim vepror, por në disa raste edhe me kuptim pësor. P.sh. në rumanishte emri participor i pashquar i prirë nga parafjalë të tilla si *de, la, pentru, după* etj. përdoret me vlerën foljore të «supinit», sipas disave⁴⁶, të paskajores, sipas disa të tjerëve⁴⁷. Kuptimi i këtyre togjeve të gramatikalizuara, si pas rrethanave, mund të interpretohet jo vetëm si vepror, por edhe si pësor. P.sh. në ndërtimet e tipit *pentru scris* (= *pentru a scrie*) o carte, am de citit (= de a citi) o carte etj. emri prejfoljor përdoret me kuptim vepror, kurse në ndërtimet e tipit *ușor* (greu) de spus [= de a fi spus] «facile (difficile) dictu» ai mund të interpretohet më saktë me kuptim pësor.

Edhe në gjuhën shqipe togu i formuar nga parafjala *për* dhe emri prejfoljor asnjanes në kallëzore të pashquar është gramatikalizuar si një formë foljore e pashtjellë me vlerë paskajoreje (me funksione të kufizuara)⁴⁸. Siç do ta shtjellojmë më tutje⁴⁹, emri prejfoljor asnjanes i pashquar i shqipes, edhe kur prihet nga parafjala *me* ose numërori *një*, ka marrë vlerë foljore me kuptim kryesisht vepror (kalimtar ose moskalimtar, sipas kuptimit të foljes përgjegjëse), por ndonjëherë edhe me kuptim mesor, vetëvetor e pësor. P.sh.

Me kuptim vepror

Me të digjuar këto, të nesërmen' na i thërret që të tria. . . ; *me të marrë* unazën [,] xgjonet. . .⁵⁰ *Me të ngarë* mishtë me dorë, edhe u ngjall një grua.⁵¹

Me të ardhur [,] pyet ç'polli⁵², . . . e *me të dalë* nga dera, u zgjuanë gjith. . .⁵³

Me kuptim mesor

Me të qasurë [,] dëgjon që llafoseshin njëra me jatërnë. . . ; *me të ngritur* [,] vështron andej [,] vështron këtej. . .⁵⁴. *Me të afëruarë* afërë kasabasë, i thotë kapetani djalit. . .⁵⁵

Me kuptim vetëvetor dhe pësor

. . . dhe *me të larë* (vetëv.), u bë njëri. . . edhe arapi me djalë lëftojënë me palla, sa u thienë të dia pallatë, edhe nonjë nga të di nuk u plagos, edhe *me të thierë* (pës.) pallatë, u rrëmbienë me duar. . .

7. Duke përmbledhur sa u shtjellua gjer këtu, del se si në shqipe ashtu edhe në rumanishte emrat prejfoljorë në shqyrtim nga ana formale përkojnë me temën e pjesores së shkuar, kurse nga ana kuptimore anojnë nga paskajorja, sepse pjesorja e shkuar, siç dihet, në gjuhët indoevro-

46) Shih G L R, I, 268.

47) Shih, ndër të tjerë, Sandfeld, 130: «Pjesorja përdoret në rumanishte si emër foljor dhe, e prirë nga disa parafjalë, sidomos nga *de*, kryen shpesh funksionin e paskajores»; Pancratz B.A.I, 147: «Ndryshe nga rumanishtja, rumanishtja përdor pjesoren e kryer pësore të prirë nga *de* (*pentru, după, la*) si paskajore, në më të shumtën e rasteve me kuptim qëllimor.

48) Shih kumtesën tonë F G P për + emër f. as., 213-220.

49) Shih § 11-14

50) Dozon, 22, 24.

51) Pedersen, Alb. T. 59.

52) Dozon, 22

53) Pedersen, Alb. T., 34.

54) Dozon, 21, 30

55) Pedersen, Alb. T., 24.

piane ka pasur dhe ka kuptim kryesisht pësor. Por lidhur me këtë pikë, do pasur parasysh edhe fakti që në këto dy gjuhë, ndryshe nga ç'ndodh zakonisht në gjuhët e tjera indoevropiane, mbiemrat e dalë nga pjesorja e shkuar nuk kanë të gjithë kuptim pësor. P.sh. në gjuhën shqipe mbiemrat pjesorë të substantivuar *i ditur*, *i ngrënë* (= që ka ngrënë), *i gjezdisur*, *i dashur* (në kuptimin e latinishtes *amans* dhe jo të lat. *amatus*) etj. përdoren me kuptim vepror. Edhe në rumanishte mbiemrat pjesorë të substantivuar *avut*, «i pasur», *știut* «i ditur», *băut* «i pirë», *mâncat* «i ngrënë» etj. përdoren gjithashtu me kuptim vepror⁵⁷. Përsa i takon shqipes, mund të pohohet se mbiemri pjesor i substantivuar *i pasur* (geg. *i pasun*) me kuptim vepror është i mbarë shqipes, prandaj duhet të jetë përdorur që heret me këtë kuptim.

Sipas mendimit tonë, në të përdorurit e mbiemrave pjesorë të substantivuar (të gjinivet mashkullore e femërore) edhe me kuptim vepror një rol jo të parëndësishëm duhet të ketë luajtur zhdukja e hershme e pjesores së tashme⁵⁸, kurse në të përdorurit e emrave prejfoljorë të tipit të *shkruar-i-t* me kuptim kryesisht vepror, një rol vendimtar duhet të ketë luajtur zhdukja e hershme e paskajores së vjetër në shqipe⁵⁹. Edhe dobësimi relativisht i hershëm i pozitave të paskajores së trashëguar nga latinishtja në rumanishte, sipas mendimit tonë, duhet të ketë luajtur një rol jo të parëndësishëm në të përdorurit e emrave prejfoljorë të tipit *scris-ul* si emra veprimi.⁶⁰

8. Lidhur me formimin e emrave me origjinë participore në gjuhën shqipe duhen dalluar dy tipa. Njëri tip, që është më i hershmi, është ai që paraqitet si një substantivim i pjesorevet më -ë pa paranyjëzim dhe pa ndonjë afiks. Mbeturina të këtij tipi ne shohim në emrin femëror *pasë-a*⁶¹, që haset vetëm tek Buzuku, i cili e përdor krahas emrit prejfol-

57) Shih Pancratz, BA, I, 87-88. Por do pasur parasysh se mbiemra pjesorë të substantivuar me kuptim vepror hasen aty-këtu edhe në disa gjuhë të tjera.

58) Ne mendojmë se shqipja e hershme duhet të ketë pasur edhe pjesore të tashme me kuptim vepror, që duhet të jetë zhdukur prej kohësh. Por mendimi i Meyer-it (*Grammatik* 43, § 118) që emrat e vepronjësit më -ës dhe -és, mund të jenë reflekte të pjesores së tashme të vjetër, mbetet për t'u vërtetuar. Për këtë shih Xhuvani - Çabej, *Prapshesat*, 42, 36.

59) Këtu është fjala për paskajoren a tipit sintetik, që është formuar që heret në gjuhë të ndryshme indoevropiane me anë morfemash të ndryshme (për këtë shih Meillet, «Introduction...», 280-281; Jespersen, 139-140) dhe jo për paskajoren analitike të tipit *me qenë*. Lidhur me këtë çështje shih vërejtjet tona në «Stud. fil», I., 1969, 82 v.

60) Edhe sikur të pranojmë hipotezën që emrat e tipit *scris-ul* në rumanishte të jenë reflekte të supinit I, siç pohohet me rezervë në I L R, I, 190, prapë mbetet për t'u shpjeguar çështja e kuptimit pësor të «supinit» rumun. Mendimi i shprehur në shën. 101 në fund të faqes 109 të kësaj vepre që «supini rumun (me parafjalë dhe kuptim qëllimor ose thjesht abstrakt foljor) mund të shpjegohet si një vazhdim i të dy supinëve latinë», na duket i pambrojtshëm. Sipas mendimit tonë, do t'ishte ndofta më e saktë të pranonim që «supini» rumun, me kuptim jo vetëm vepror por edhe pësor, është vazhdimi i pjesores së kryer latine më -to-, që, siç pohohet edhe në I L R, 192-195, edhe në latinishte është përdorur jo vetëm me kuptim pësor, por edhe me kuptim vepror.

61) Buzuku, 53/a (2 herë), 69/b, 187/a (2 herë).

jor asnjane të *pasun-i-të*⁶² në një raport dëndurie 5: 4; si edhe në gegizmat *dekë-a*, (çam. *vdekë-lë*), *lypë-a* etj. Ky tip substantivimi i pjesores, që nuk është i panjohur edhe në toskërishte⁶³, me kohë erdh e u zmbars nga gjallërimi i hershëm i emrave prejfoljorë asnjane të paranyjësuar si edhe nga emrat prejfoljorë prapashtesorë të tipit *vdekë-lë*, *vdek-je*⁶⁴.

Tipi tjetër, që është bërë shumë më produktiv se i pari dhe që duhet të jetë gjithashtu mjaft i vjetër, është ai i substantivimit të pjesorevet të paranyjësuar, d.m.th. të adjektivuara, të gjinisë asnjane, e në një fazë më të vonë edhe të gjinisë femërore. Zanafilla e këtij tipi substantivimi duhet kërkuar në një kohë kur paranyjësimi i pjesorevet të adjektivuara ishte përgjithësuar në shqipen e përbashkët dhe kur gjinia asnjane ishte shumë e gjallë në ndërgjegjen e stërgjyshërvet të shqiptarëvet. Pas gjithë gjasavet, kjo kohë duhet të jetë më e hershme se fillimi i kontaktevet të shqipes me sllavishten, sepse në kohën e hyrjes së sllavizmave në shqipë ndjenja e asnjanesit në këtë gjuhë duhet të ketë qenë dobësuar. Këtë gjë, sipas mendimit tonë, e vërteton fakti që ndëron huazimet sllave të shqipes nuk ka emra të gjinisë asnjane⁶⁵. Po të kishte qenë mjaft e gjallë ndjenja e gjinisë asnjane në gjuhën shqipe në kohën e hyrjes së sllavizmave, disa nga emrat sllavë (asnjane ose asish që mund të interpretoheshin si të tillë), me siguri do të ishin interpretuar si asnjane në gjuhën shqipe⁶⁶, ashtu siç janë interpretuar një numër jo i vogël emrash asnjane (dhe joasnjane) latinë⁶⁷.

Për lashtësinë e emrave prejfoljorë asnjane në gjuhën shqipe dëshmon edhe përhapja e tyre e gjërë dhe e konsoliduar mirë tek autorët tanë të vjetër (duke përfshirë edhe Matrëngën) si edhe në të folmet e arbëreshëvet të Greqisë e të Italisë.

Në një fazë relativisht të vjetër të shqipes ky tip substantivimi u bë mjeti kryesor për të shprehur veprime abstrakte dhe gjëndje, gjë që duket qartë, p.sh., nga gjuha e autorëve tanë më të vjetër (Buzuku, Matrënga, Budi) të cilët, sipas mendimit tonë, në këtë pikë shënojnë *terminus ad quem* të gjallërisë më të madhe të këtij tipi emrash të shqipes. Një nga pasojat e këtij gjallërimi ka qenë edhe largimi gjithnjë e më i madh i këtij tipi emrash, nga ana kuptimore, prej klasës së mbiemrave dhe afrimi i tij me klasën e emrave. Për këtë flet qartë jo vetëm fakti i

62) Po aty, 27/b, 69/a, 70/b, 161/a.

Do pasur parasysh se Budi përdor vetëm emrin prejfoljor asnjane të *pasun-i-të*, si p.sh. në DC, 58, 60, 81, 125, 129. Po kështu edhe Bardhi: Prædium — *Të pasunë*.

63) P.sh. *vdekë* tek arbëreshët e Kalabrisë (shih Xhuvani-Çabej, *Prapashtesat*, 40, shën. II.). Ndofta edhe emrat *sosë* e *kullotë* janë pjesore të substantivuara. Të kihet parasysh edhe forma *nisë-të* te Grigori (Marku 1/1) krahas të *nisurat* (Math. 24/3).

64) Për prapashtesat *-lë*, *-je* shih Xhuvani — Çabej, *Prapashtesat*, 62, 65.

65) Nga huazimet sllave vetëm emri *plehë*, i cili në sllavishte ka qenë femëror (shih Selishçev, f. 160), ndeshet si asnjane tek Budi (SC, 47) si edhe në të folmen e Skraparit (shih Gjinar, «BUSHT, SShSh, 1, 1958, 92) dhe në të folmen e Bregdetit të Poshtëm (shih Totoni, «St. fil.» 1, 1964, 145). Ky asnjane analogjik, siç shihet, ka një përhapje të kufizuar.

66) Të kihet parasysh se në ato gjuhë që e kanë ende shumë të gjallë ndjenjën e gjinisë asnjane, huazimet, që emërtojnë jofrymorë, interpretohen shpesh si asnjane në përphtje me normat, që veprojnë në ato gjuhë. P.sh. në greqishten e re huazime të tilla si *tram*, *aeroplan*, *çaj* etj. përdoren si emra asnjane.

67) Nuk po merremi më gjatë me këtë çështje, të cilën e kemi trajtuar më gjërë në një punim ende të pabotuar.

vënë në dukje më sipër që emrat prejfoljorë të këtij tipi, kur formohen prej foljesh transitive, kanë kuptim kryesisht vepror, ndërsa mbiemrat përgjegjës të substantivuar të gjinisë mashkullore e femërore kanë kryesisht kuptim pësor, por edhe fakti tjetër që në gjuhën shqipe mund të krijohen emra prejfoljorë asnjans pa ekzistuar mbiemra prejfoljorë të substantivuar, e madje edhe të pasubstantivuar, të gjinisë mashkullore ose femërore⁶⁸. Prandaj, megjithëse në krye të herës emrat prejfoljorë në shqyrtim u krijuan me anë të substantivimit të pjesorevet të adjektivuara të gjinisë asnjansë, me kalimin e kohës ata u ndjenë si emra thjesht prejfoljorë.

Lidhur me diferencimin kuptimor të emrave prejfoljorë asnjans nga mbiemrat prejfoljorë të pasubstantivuar dhe të substantivuar të gjinivet mashkullore e femërore, do pasur parasysh se në gegërishte (pjesërisht edhe në toskërishte) edhe emrat prejfoljorë të gjinisë femërore të tipit e *hangm-ja*, e *ikmja* etj.⁶⁹ shënojnë veprime abstrakte, pra, kanë kuptim vepror, kurse si mbiemra prejfoljorë të substantivuar të gjinisë femërore kanë rregullisht kuptim pësor.

Në të tilla rrethana, emrat prejfoljorë asnjans të shqipes në planin sinkronik nuk mund të interpretohen më si mbiemra pjesorë asnjans të substantivuar por emra prejfoljorë asnjans, term ky që duhet parapëlqyer edhe për këtë arsye: Një klasë fjalësh nuk duhet emërtuar sipas klasës, nga e cila është formuar, por sipas vlerës, që ka aktualisht në gjuhë. Përndryshe, edhe emrat e tipit *dekë-a*, *lypë-a*, *sosë-a* etj., duhej t'i quanim jo emra të gjinisë femërore, por pjesore të substantivuara të gjinisë femërore. Po kështu, fjalët *pranë*, *afër*, *larg* etj. në funksion parafjalor, do të duhej t'i quanim ndajfolje të parafjalëzuara e jo parafjalë me burim ndajfoljor⁷⁰.

Shënim. — Për përkatësinë kategoriale të formës së tipit *së bëri* në togfjalëshat e tipit *mbarova së foluri* dhe *u lodha së foluri* shih artikullin tonë në «Stud. fil». 1, 1969, 108-116.

II

TOGJET ME VLERË FOLJORE TË FORMUARA ME PJESËMARRJEN E EMRAVET PREJFOLJORË ASNJANËS.

9. Gjatë zhvillimit historik të shqipes janë përfutuar disa togje më vlerë foljore, të formuara nga emra prejfoljorë asnjans në kallëzore të pashquar, të prirë prej parafjalëvet *për*, *me*, ose prej numërorit *një*. Këto

68) P.sh. nga *Buzuku: të abituom, të deshpëlqyem, të firmuom, të murmurom, të përgjeggjunë, të proveduom* etj.; nga *Matrënga: të anastisurë, të arësierë, të ksemolloisurë, të sarkosurë, të sinodepsurë* etj.

69) Emrat prejfoljorë femërorë të këtij tipi janë sajuar nën ndikimin e formave të shumësit, që u kuptuan si femërore, në një kohë relativisht të vonë, d.m.th. atëhere kur pozita e asnjansit ishte lëkundur shumë.

70) Për të njëjtën arsye mendojmë se edhe fjalët e tipit *të zi-të, të verdhë-t, të ri-të* etj., që në shqipen e sotme paraqiten si njësi leksikore të krijuara me anë të substantivimit të formës asnjansë të mbiemrave përkatës, duhen quajtur emra prejmbiemërorë e jo mbiemra të substantivuar. Termi mbiemër i substantivuar, sipas mendimit tonë, do përdorur vetëm kur kemi të bëjmë me substantivime mbiemrash të karakterit gramatikor (kontekstual).

togje, dikur të lira, me kohë janë ngurosur (d.m.th. emrat, që bëjnë pjesë në këto togje kanë humbur tiparet emërore) dhe kanë marrë vlera kuptimore e tipare gramatikore, që janë karakteristike për format e pashtjella të foljes⁷¹.

a) Nga fusha e morfologjisë do përmendur këtu:

1) Ngurosja e emrit prejfoljor asnjanes në formën e kallëzores së pashquar, pa pasur kështu mundësi që të përdoret edhe në trajtën e shquar, ashtu siç do të mund të përdorej jashtë togjeve në shqyrtim.

2) Përdorimi i këtyre togjeve në diatezat pësore-vetëvetore me pjesëzën përemërore *u*. Kjo vihet re sidomos në togun e formuar me emrin prejfoljor asnjanes të prirë nga parafjala *për*. Përdorimi i këtij togu me pjesëzën përemërore *u* për gegërishten dokumentohet që tek Bogdani⁷², kurse në toskërishte një përdorim i tillë haset mjaft vonë⁷³. P.sh.:

... e se aj nukë ka me çelë gojëne *për t'u nëkuem*. «e che egli non aprirà la bocca per dolersi.» Tash' pra jet *për t'u shqyrëtuem* si është ... «Hora resta da vedersi come ...»⁷⁴; Aj ka shenja *për t'u njoftë*⁷⁵...;

... edhe u nis *për të u nkëthyerë* me nxitim ndë vënd të çupës. Të pastajmen çupëza shtrënguarë tepërë prej t'et *për të u martuarë*, muarr morrë...; ... i thot' asajë të hynjë çpejto brënda ndë drithnik *për të u mpruajturë*...⁷⁶ Flaka dhe tymi dukeshin edhe ata sikur po zgjateshin në rrugën e tyre për të arritur kupën e qiellit, *për t'u bashkuar* me zjarrin e yjeve. Këtu për të çdo gjë ish e trazuar: balta me ujin për të ngritur kasolle; balga me zjarrin *për t'u bërë tym* e zbuar konupet⁷⁷. ... kurse ajo shkoi duke qarë në drejtori *për t'u ankuar*. ... që në kohërat e legjendave të Gjergj Elez Alisë, kur e keqja dilte gjithmonë nga deti si

71) Për togun foljor të tipit *për të punuar* shih edhe vërejtjet tona në «Stud. fil.» I, 1969, f. 101-108

72) Tek Buzuku e tek Budi në diatezat pësore-vetëvetore togu me vlerë foljore i tipit *për të punuar* përdoret pa pjesëzën përemërore *u*. Ja disa shembulla nga Buzuku... e duojtë taj i kishnë ngjeruom e prunjshinë *për të nfallë* timit... «[putabam] ... vestrosque manipulos circumstantes adorare manipulum meum». (Buzuku, 66/b, Genesis, 37/7); ... e u apë korpnë tem *për të djegunë*. ... «et si tradidero corpus meum ita ut ardeam» (Buzuku 50/b, ad Corinthios, I, 13/3). ... e qi ashtë mǎ i mirë e i denjë *për të lëvduom e për të nderunë* ... (Budi, SC, 214).

73) Në shkrimet e bejtexhivet, tek Bibla e Korfuzit, në veprat e dy vëllezërvet frashëriotë, në përrallat e mbledhura prej Pedersenit etj. togjet foljore me pjesëzat parafjalore *për* dhe *me* në kuptim pësor-vetëvetor nuk përdoren me pjesëzën përemërore *u*. P. sh.; Erdhi vakti *për të ndarë* (= për t'u ndarë)...; .. erdhmë *për të shëruarë* (= për t'u shëruar) (M. Çami, *Erveheja*, B SH SH, I, 1957, 255, 271). Edhe gjithë punërat e ture i bëjnë *për të dukurë* ndë njerëz... (Grigori, Math. 23/5); ... edhe ca nga mbretërit' e mbëdhha ... do të hynjë në mest, *për të mos ndezurë* zjari... Kufit' e veriut të Shqipërisë, *me të ndarë* nga an' e detit ngjitenë drejt veriut... (S. Frashëri, *Shqipëria*, 25). Kur erth koha *për të ndarë*... (= për t'u ndarë) (Naimi, I S, 221)... dhe *me të larë* (= me t'u larë), u bë njeri... *me të afëruarë* (= me t'u afruar) afërë kasabasë, i thotë kapetani djalit... (Pedersen Alb, I, 63, 33, 24 me të *qasurë* (= me t'u qasur) dëgjon që llafoseshin njëra me jatërnë... *Me të kthyer* (= me t'u kthyer) she dervishin që i dolli përpara. *Me të ngritur* (= me t'u ngritur) vështron andej (Dozon, 21, 27, 30).

74) Bogdani, pj. II, I/VII/4; pj. I, I/I/19.

75) K P L, 63.

76) Mitko, 182, 184, 188.

77) Xoxa, I/57, 203.

një përbindësh dhe duhej çfarosur mu në breg të detit, për të mos u futur në tokë⁷⁸.

Kohët e fundit vihet re prirja për të përdorur pjesëzën përemërore *u* edhe në togun e formuar me pjesëzën parafjalore *me* e aty-këtu edhe në togun me numërorin *një*.

Dhe grizarakja u tërhoq *me t'u zhdukur* frika e rrezikut e *me t'u bërë* më i qartë ky mendim. . . Adili kishte zënë të shtruarat, *me t'u kthyer* nga pazari. . . një të ikur unë nga shtëpia e *një t'u çthurrur* gardhi⁷⁹. *Me t'u hapur* dera, . . . të gjithë kthyen kryet andej⁸⁰.

b) Nga fusha e sintaksës duhen përmendur:

1) Të përdorurit e këtyre togjeve në forma të ngurosura, me emrin prejfoljor asnjës në kallëzore të pashquar, pa pasur mundësi që ky të përcaktohet nga një mbiemër ose nga një emër në rasën gjindore, ashtu siç mund të ndodhë, po të përdoret emri prejfoljor asnjës në një tog të lirë⁸¹. Është e vërtetë se në veprat e autorëvet tanë të vjetër hasen rrallë e tek edhe ndërtime, në të cilat emri prejfoljor asnjës i pashquar, i prirë nga parafjala *për* (ose *me*), ndiqet nga një fjalë tjetër përcaktuese⁸². Por në shqipen e sotme ndërtime të këtij lloji nuk hasen më. Edhe në shkrimet e autorëvet të Rilindjes ato hasen shumë rrallë, me emrin prejfoljor asnjës në trajtë të shquar, si p.sh. tek Sami Frashëri: . . . nxuarë në shesht dëshirënë që ka pasurë të shprehurë në zëmër çdo shqipëtar i ndrituarë *për të shkruarët* të gjuhës' së bukur sanë. *Me të rënë*t të kësaj stihije së madhe, do të bjerë edhe Shqipëria. . .⁸³.

2) Të përdorurit e pjesëzës së mohimit *mos* në fjali të aspektit mohor, ashtu siç ndodh edhe me format e pashtjella të foljevet të tipit *me punue* dhe *duke punuar*. P.sh.

. . . tue pasunë heshtunë, *për të mos çtuem* të dhimptunë. . . «essen-do stata chetta, per non accrescere maggior dolore. . .»; . . . kurraj *për të mos dalë* andy *«mai di uscire di là»*⁸⁴ . . . e për të vithisurë bashkë në trap të thellë të humbjesë tek po bjenë, *për të mos dalë* kurë.⁸⁵ . . . *për të mos ia shkrehur* vajit në sy të burrave.⁸⁶

3) Të përdorurit e këtyre togjeve me kundrina të drejta e të zhdrejta, të shprehura jo vetëm me anë emrash e përemrash, përkatësisht në rasat kallëzore e dhanore, por edhe me anë trajtash të shkurta të përemravevetorë. (Siç dihet këto të fundit përdoren vetëm me forma foljore). P.sh.:

. . . veçë *për të na bām* me dītunë se. . . «. . . se non per significare che. . .»; . . . qi ka ungunë kryetë *për të të marrë* ngrykë e *për të të avi-*

78) Kadare, 62, 103.

79) Xoxa, III/247, 68, 130.

80) Musaraj, Para, II/478

81) Megjithatë, do pasur parasysht se këto togje të pandjekura nga ndonjë fjalë përcaktuese, mund të përdoren rrallë e tek si togje të lira në ndërtime si këto: Sa *për të folur*, atij s'ia dilte dot njeri. — Kjo nuse — thotë plaku, — *për të pam* s'e ka shogën. . . (D. Kurti, Pralla, II, 124).

82) P.sh. tek Buzuku, 132/ a-b.

Tek autorët e vjetër në ndërtime të këtij tipi emri prejfoljor asnjës haset kryesisht në trajtë të shquar.

83) S. Frashëri, Shqipëria, 47, 52.

84) Bogdani, pj. II, III/III/11; IV/IV/21

85) S. Frashëri, *vep. cit.*, 42.

86) Xoxa, II/200.

tunë...»... che egli ha chinato la testa per abbracciarti, & baciarti...»⁸⁷; ... rasti dhe mjetet për ta nisur përsëri ikin dhe nuk këthehen prapë. ... Për të mos i mbetur hatri askujt...⁸⁸... sikur të kërkonin lejë nga njëra tjetra për t'i vajtur në ndihmë... Ai zgjati duart mbi gardh, si për ta marrë vajzën hopa... Megjithëse Piloja brofi në këmbë me ta parë...; ... pastaj, me t'i kthyer frerin pelës, ngau skatraz⁸⁹. Me të më parë mua, ai rralloi çapat... Me t'i parë nga larg, njerëzit ndërrojnë udhë. Po, me ta kuptuar që ai s'ish i shtëpisë, u tërhoq më të prapë...⁹⁰.

4) Gjithashtu do pasur parasysh se këto togje të ngurosura, përveç kundrinavet dhe plotësvet rrethanorë, mund të marrin dhe kryefjalë. P.sh.

... veçë jet për t'u dītunë moti kur ka me kjanë: «resta solo di sapere il tempo quando ha da essere»⁹¹... të cilënë sulltan Mehmeti e ka mbyllurë me paditurit të ti për të mos hyrë aniet' e Venecanëvet...; Për të ndërtuarë kjo fushë [,] duhetë të hapenë lumenjtë⁹². Për të mos i mbetur hatri askujt, përfundoi ta thërrisë Kuvendin e Kapedanëve në Lesh...⁹³. Dy burrat e tjerë kishin shkuar njëri për t'u hedhur tagji kuajve e tjetri për të mbledhur një krah dru... e kaloi në të ndarën tjetër, pas banakut, që dyqanxhiu e ruante për të pirë rredhi e shokëria e tij...⁹⁴. Me të folë djali, zuri birbil gjizari e këndon...; E me të thënë veziri ato fjal, mblihetë djali edhe këceu mbërnda në kazan⁹⁵. Me të shkuar Hajredin Pasha, kapedanët e Myzeqesë i dbuan turqit nga Berati edhe Kosturi⁹⁶. Po pastaj, me të arritur lëngu i njelmët thellë në qiellzë, grizarakes... iu ter edhe e paka pështymë... Atllarët... me t'iu buçitur në vesh grahma e detit, hingëllimat dhe rehmatjet e kafshëve të lira, nuk përmbaheshin më dot⁹⁷.

Shënim. — Për vlerat funksionale të togjeve foljorë në shqyrtim do të bëhet fjalë më tutje, në paragrafët përkatës.

c) Nga pikëpamja semantike, siç e kemi vënë në dukje edhe më parë⁹⁸, si parafjala për dhe parafjala me (ose numërori një) ashtu edhe emri prejfoljor në këto togje të gramatikalizuara nuk përdoren me kuptimet e tyre të zakonshme si fjalë të veçanta. D.m.th., as fjalëza për as fjalëza me në këto togje nuk shërbejnë për të shprehur lidhjen sintaksore të emrit prejfoljor asnjane me një gjymtyrë tjetër të fjalisë, as fjalëza një nuk shërben për të treguar sasi, dhe as emri prejfoljor asnjane nuk emërton një veprim abstrakt ose gjëndje. I gjithë togu në raste të tilla përdoret si një fjalë e vetme me kuptim foljor, pra, si një formë gramatikore perifrastike me vlerë foljore, që tregon një veprim ose gjëndje si proces.

87) Bogdani, pj. I, II/II/11; pj. II, III/III/5.

88) Noli, 29-30, 32.

89) Xoxa, I/34; III/225; I/34; II/36.

90) Musaraj, Para, I/423, 433; II/372.

91) Bogdani, pj. II, IV/IV/8.

92) S. Frashëri, Shqipëria, 80, 79

93) Noli, 32.

94) Xoxa, I/58, III/35.

95) Pedersen, Alb. T. 35, 66.

96) Noli, 9.

97) Xoxa, I/121; III/276.

98) Shih kumtesën tonë në Konferenca I, 215-216, si edhe «Stud. fil.» 1. 1969, 105 v.

A.

10. Togu i gramatikalizuar për + emër prejfoljor asnjans në kallëzore të pashquar

Vlerën foljore të këtij togu nuk e kanë njohur të gjithë studjuesit e shqipes. Mjafton të përmendet se gjuhëtarë të tillë si S. Frashëri⁹⁹ e Xanoni nuk e kanë trajtuar fare këtë tog si një formë foljore perifrastike. Por shumica e atyre që janë marrë me përshkrimin e strukturës gramatikore të shqipes, në një mënyrë a në një tjetër, e kanë njohur vlerën foljore të tij. Kështu kanë vepruar Da Leçeja¹⁰⁰, Hani¹⁰¹, Kamar-da¹⁰², Dozoni¹⁰³, Kristoforidhi¹⁰⁴, Majeri¹⁰⁵, Pekmezi¹⁰⁶, Vaigandi¹⁰⁷, She-

99) Megjithatë, S. Frashëri këtë formë e përmend një herë në f. 71 të gramatikës së tij, kur bën fjalë për kohën e ardhme. Ja si shkruan ai: «Është edhe një farë moti i pritmë i përzjerë prej të tanishmit a të rrëfyeshtit të së premes' së foljes ndihmëse *pasurë* edhe prej të paçquamesë, në mest të së cilave hyn përpara, për pas toskëvet, a me, pas gegëvet, si: *kam për të pasurë, kam me pasunë, a kam me pasë, kisha për të pasurë, kisha me pasunë, a kisha me pasë*».

100) Da Lecce në veprën e tij formën perifrastike të tipit *për të kënduem* (f. 53) dhe atë të tipit *kam për të kënduem* (f. 47) i trajton si forma të paskajores së ardhme me nuancë domosdoje.

101) Hahn-i në pjesën e dytë, f. 88, të veprës së tij shënon se «konstrukti participor» i sajuar nga emri participor i prirë prej para-fjalës *për* «lejon akoma më pak se [konstrukti] i mëparshëm [tuke tundurë] një përkthim fjalë për fjalë në gjermanishtë». Pastaj ai rendit disa shembëlla, ku togu i tipit *për të punuar* është përdorur me funksion kallëzuesor, atributiv dhe qëllimor si: *Kush ishte për të ardhurë, e të vijë, kush ishte për të mos ardhurë, e të rijë. Rushtë janë për të ngrënë. Ishtë njeri ... për të mos folë, për të mbiturë. ... kuvenduanë ... për të varë* atë:

102) Camarda, megjithëse në Saggio, 268, pohon se paskajorja mungon në dialektin tosk, duke përfshirë arbërishten e Italisë, në f. 329 shënon se «forma me para-fjalën *për* ka një përdorim të ngjashëm me paskajoren e Italishtes të prirë nga *da* ose *per*: vajza ishte *për të martuarë*...; ai ç'ishtë *për të ardhurë*: ... jam *për të ngrënë*, *për të nisurë* ...» Edhe në Appendice, f. 3, shën: 4, Camarda, kur shpjegon formën *për të dëgjuarë* me italishten *për udire* dhe me greqishten *ὕπερ τοῦ ἀκούειν*, shton shënimin «një nga format e paskajores».

103) Dozoni në veprën e tij, f. 313, thotë se emri prejfoljor asnjans i prirë nga *për* «shërben për të shprehur paskajoren». Në f. 226 ai shënon gjithashtu se në «Shqipërinë qëndrore» përdoret një e ardhme e dytë e formuar me ndihmësen *kam* dhe me «formën e paskajores *për të* ...». Sipas tij, *kam për të lidhurë* ka kuptimet «j' ai à lire, je dois lier» si edhe «je lierai».

104) Kristoforidhi në gramatikën e vet formën *perifrastike për të kërkuarë* (f. 123) e trajton si një formë të paskajores së tashme. Ai jep edhe format perifrastike të së ardhmes, përkatësisht të kushtores, *kam për të pasë* (f. 104), *kishjem për të pasë* (f. 123), *kam për të pasë pasë, kishjem për të pasë pasë* etj. (f. 105, 109). Për këto shih edhe kumtesën tonë në Konferenca I, 213 v.

105) Meyer-i (Grammatik, 43) shkruan: «Në një numër lidhjesh pjesorja, sidomos me nyjen e përparme të shërben për të shprehur paskajoren që mungon; p.sh. *erdha për të shiturë*...»

106) Pekmezi formën perifrastike tipit *për të hapur* e jep si paskajore të toskërishtes (Grammatik, 73,79,195).

107) Weigand-i, Grammatik, 135, thotë se në Elbasan përdoret «pas mënyrës toskë» edhe konstrukti i tipit *për të hangër* në vend të konstruktit të tipit *për me hangër*.

peri¹⁰⁸, A. Filipide¹⁰⁹, Myderrizi¹¹⁰, Cipua¹¹¹, Xhuvani¹¹², Gabinski¹¹³. etj.

Disa prej këtyre si Da Leçeja, Dozoni, Kristoforidhi, Majeri, Pekmezi etj. e kanë trajtuar atë si një formë perifrastike me vlerë paskajoreje. Disa të tjerë si Vaigandi, Sheperi, Cipua¹¹⁴, e kanë pranuar përdorimin e këtij togu me vlerë paskajoreje vetëm për toskërishten, por nuk e kanë quajtur kështu. Për pikëpamjet e Gabinskit lidhur me këtë tog foljor shih artikullin tonë në «Stud, fil.» 1, 1969, f. 101 v.

Siç e kemi vënë në dukje edhe më parë¹¹⁵, togu i formuar nga parafjala për dhe emri foljor asnjane në trajtë të pashquar në të dy dialektet e shqipes përdoret kryesisht si një formë e pashtjelluar foljore me vlerën e një paskajoreje me funksione sintaksore të kufizuara. Kjo formë gramatikore e pashtjelluar përdoret në funksione sintaksore të ndryshme, nga të cilat pjesa më e madhe janë të përbashkëta për të dy dialektet.

1) Në funksion qëllimor. — Në një funksion të tillë në gegërishte, sidomos në gegërishten veriore, përdoret më dendur paskajorja e tipit (për) me punue. Prandaj edhe në shembëllat e mëposhtme nga dialekti geg forma perifrastike e tipit për të punuar mund të zëvendësohet fare natyrshëm me atë të tipit (për) me punue. P.sh.: ...porsi qengji që sillet për të ntherunë... «sicut ovis ad occisionem ducetur...»; i kini kujdes për të ruojtunë «habetis custodiam»¹¹⁶ ... të kietë ashtu ende një anëth me ujë për të lām duortë e napënë e dëlirë për të mpshim...¹¹⁷; ...u ngrenë të shtatë vëllezërit të zijnë vëndet për të lëftuar... Në pazar e shpie për të shitur¹¹⁸. Për të ndarë të krishtenët për jetë nga myslimanët, e për të hapurë në mest të tyre një trap të thellë, qeveri e turkut shqiptarët' e krishtenë s'i njuh për shqipëtarë...; Për të pasurë pakë fuqi në Shqipëri [,] kishinë sjellë disa kolonja romanësh¹¹⁹. Shqiptarët posa kishin nisur luftën e madhe për të shkundur zgjedhën e rëndë të sërbëve. ... mi të cilat u pështet më vonë Skënderbeu për të nisur fushatën e tij të paharruarshme¹²⁰. — Ore lalë, s'kam ardhur këtu për të bërë gjyq... Dhe i gjori fshatar që me mëngjez pa hapur grykën e qesësë për të hedhur ndonjë lek, detyrohej që ta zgjidhte për të paguar...¹²¹

Shënim. — Në funksion qëllimor ky tog foljor mund të përdoret edhe me pjesëzën si (me nuancë mënyrore), ose me pjesëzën sa (me nuancë kufizuese). P.sh.:

108) Sheperi *Gramatika*, 183, thotë se në toskërishte në vend të paskajores përdoret gjinia asnjane e mbiemrit pjesor me parafjalën për, p.sh. me shkruar = për të shkruar.

109) A. Philippide në veprën e tij *Originea romtnilor*, f. 616, pohon vlerën infinitivale të togut foljor të tipit për të punuar.

110) *Gramatika e Re*, 127.

111) *Gramatika*, 120, *Sintaksa*, 47.

112) *Studime gjuhësore*, 211.

113) Shih, ndër të tjera, veprën e tij Voznikovenije infinitiva kak vtoričnyj ballkanskij jazykovoj process, f. 161-246.

114) Në *Sintaksa*, 47, Cipua e quan këtë formë edhe «infinitivi me për të».

115) Konferenca I, 215-228, «Stud. fil.» 1, 1969, f. 104 v.

116) Buzuku, 103/a (Isaia 53/7); 100/b (Math. 27/65).

117) Budi, R R, 94.

118) Pedersen, Alb. T. 38, 70.

119) S. Frashëri, *Shqipëria*, 48-9, 8.

120) Noli; 5, 10.

121) Xoxa, II/149; III/57.

a) Ahere ngriti sytë, pa kosovarin dhe tundi kokën si për ta falënderuar... Ai zgjati duart mbi gardh si për të marrë vajzën hopa.. Dhe po e vërtiste në ajër si për të kërkuar vendin ku të godiste¹²².

b) Lëvizte vetëm buzët sa për të kapërxyer pështymën... U duk që fjalët e fundit i tha sa për t'i dhënë zemër djalit... Qe futur në kafene vetëm sa për të shikuar...¹²³ Duhet ta pranojmë që ne nuk njohim asgjë dhe jemi futur vetëm dy metra në tokën e tyre sa për të nxjerrë të vdekurit¹²⁴...

2) Në funksion caktuesor. — Edhe në një funksion të tillë kjo formë perifrastike në gegërishte mund të zëvendësohet me atë të tipit (për) me punue. P.sh.:

... e na jemi mbajturë porsì dhentë për të nvrinë¹²⁵. «aestimati sumus sicut oues occisionis». ...kurrëj pa pasunë ndonjë shpëresë për të shpëtuom¹²⁶... E se ajo ligj të kish pasunë vertyt për të shëlbuem: «Che se quella legge havea forza a salvarci.¹²⁷ ...u vete të gjij ilaç për të pjell...¹²⁸ Shqipëria... ka njerës të zottë për të qeverisurë. Pas udhëvet m'e para punë për të bërë është Myzeqeja. ...Kombi shqiptar s'është komp për të pasurë turp prej ti¹²⁹... ..dha urdhër për të nisur betejën... Nukë kishte artileri për të qënë...¹³⁰... po, kur erdhi puna për ta dërguar, mbeti. ...aq më tepër i shtohet malli për ta parë e për t'i folur... Po, merre, moj Vitë se s'ke një fustan për të qënë...¹³¹. Më ndodhi dishka e papritur, dishka për të qeshur, e për të qarë. Një qëndrim pak si për të qeshur mbante zoti Banka...; ...rrallë e tek të zinte syri ndonjë të ri me veshje për të qënë¹³².

3) Në funksion kallëzuesor, si pjesë e një kallëzuesi të përbërë të formuar me pjesëmarrjen e foljes *jam* (në përdorim vetor ose pavetor) dhe *kam*, ose të foljevet *bëhem*,¹³³ *mbetet*, *jet* (dy të fundit kryesisht në përdorim pavetor) etj. Në të gjitha këto raste togfjalëshi kallëzuesor shpreh zakonisht edhe nuancën e detyrimit. Kjo nuancë është më e theksuar, kur në funksion këpujor përdoret folja *jam* (si folje vetore ose njëvetore), e cila bashkë me formën e paskajores së tipit *për të punuar* ka vlerën e gjerundivit latin të shoqëruar nga folja *esse*¹³⁴. Në këta togfjalësha kallëzuesorë, sidomos në ata me foljen *jam*, paskajorja e tipit *për të punuar* në gegërishte zakonisht nuk zëvendësohet me atë të tipit *me punue*. P.sh.:

122) Xoxa, I/36; III/225; II/40.

123) Musaraj, Para, II/50, 124, 212.

124) Kadare, 56.

125) Buzuku, 178/b (ad Romanos, 8/36).

126) Budi, DC, 134.

127) Bogdani, pj. I, I/V/7.

128) Pedersen, Alb. T. 35.

129) S. Frashëri, *Shqipëria*, 35, 79, 92.

130) Noli, 27, 123.

131) Xoxa, I/215; III/60, 160.

132) Musaraj, Para, I/347; II/17.

133) Funksionin kallëzuesor të togfjalëshit *bëhem* + paskajoren e tipit *për të punuar* e ka vënë në dukje edhe F. Agalliu (shih Konferenca I, 378).

134) Por, kur paskajorja e tipit *për të punuar*, e prirë nga një formë vetore e foljes *jam*, përdoret me kuptim të qartë vepror ose intransitiv — mesor, atëhere togfjalëshi kallëzuesor nuk shpreh ndonjë nuancë detyrimi. P.sh.: *Qeveri e tyrqet në Shqipëri është vetëm për të mbledhurë pagesat e ushtarët... Monedhat e argjëntta e të niqelta do të jenë vetëm për të mbushurë sumat' e vogëla... (S. Frashëri, *Shqipëria*, 50, 84).*

a) E kur ky qi *anshtë për të vdekunë të nvishetë pā mort...* «Cum autem mortale hoc induerit immortalitatem»¹³⁵; ... prāshtu këto kafshë fort janë për të vum roe e për të dijtunë se janë për një të madh gazimend e ngushëllim...¹³⁶; .. ajo punë ishte për ta çmuem e përbuzunë... «ciò era un burlarsi di lui...»¹³⁷; .. motra ia gjet moters e s'asht për t'u bindë...¹³⁸ .. kush do të bëhetë princ e mbret a ç'është për të quajturë krej i qeverisë¹³⁹ .. Mënyra, me të cilën u fitua beteja e Nartës, është për të vënë re, se...¹⁴⁰; .. dhe ajo që shkruhej atje brënda... ishte për ta puthur e vënë në ballë... Sa për të qeshur, sikur të mos ishte për të qarë¹⁴¹; Zefit i ngjau diçka tjetër, që ish me të vërtetë për të qeshur... Qan kur është për të qeshur... Ç'qesh? Për të qeshur është? Dhe do ish vërtet për të lenë mendjen sikur ti të ushqesh ndaj tyre po atë besim akoma sot... Po kjo s'duhet të na bëjë neve të mbyllim gojën edhe kur s'është për të mbyllur¹⁴².

Shënim. — Në ndërtime të këtij lloji togu foljor në shqyrtim mund të përdoret edhe me pjesëzën kufizuese *sa*. P.sh. Po mendimi i mjekut ishte që ky ilaç ishte *sa për të shtytur* ditët¹⁴³.

b) ... përse na mundë shohmë ato kafshë qi na *kemi për të vepëruom*¹⁴⁴. «ut videre possimus, quae agenda sunt» ... po gjithë vepërojnë ndomosdo, gjithë qish kanë për të bām... » ma tutte operano necessariamente quello che hanno da fare... »; ... qish ke për të bām, bane çpejt. «ciò che tu hai da fare, fallo presto». Po gjithë veprojnë ndomosdo gjithë qish kanë për të bām. «Ma tutte operano necessariamente quello che hanno da fare...»¹⁴⁵ ... po të veç telal në të gjithë ulqe tënde, që kushdo që ka për të shkruar kartë për nek ajo dunja, të shkruanjë...; ... edhe iku vate ne çelëngai, që kish dhëntë të gjitha për të ngordhur...¹⁴⁶; ... kush ka për të marrë gjak, ta dhuronjë¹⁴⁷. Edhe atyre që kishte pas, u thoshte që për një gjeneral të mirë është aqë nevojë ta dijë vëndin që ka për të mbrojtur, sa edhe numrin edhe cilësinë e ushtërisë mrike¹⁴⁸. .. është më mirë të kemi për të marrë se për të dhënë... shpeshëria futur në mullarët me byk, sikur të paskëshin për të pjellë ato ditë edhe zogat, që s'e kishin nisur barkun e parë...¹⁴⁹ Emira Velo kish shumë për të shprehur¹⁵⁰.

c) E gjithë veshëtë e popullit u banë për të ndigluom...¹⁵¹ «et aures omnis populi erant erectae...» ... ndo gjithë të bāheshinë për të mbytnë... altrimente fossero tutti fatti uccidere...¹⁵². E si shkoi ca vaht, që u bënë vashast të tria për të martuarë...¹⁵³. Ahere iu kujtua se e bija ishte

135) Buzuku, 185/a (ad Corinthios, I, 15/54)

136) Budi, SC, 8.

137) Bogdani, pj. II, III/I/11.

138) Kurti, I/99.

139) S. Frashëri, *Shqipëria*, 67.

140) Noli, 8.

141) Xoxa, I/95; II/198.

142) Musaraj, Para, I/332, 352-3; II/432, I/219, 74.

143) Musaraj, Para, I/212.

144) Buzuku 59/a.

145) Bogdani, pj. I, I/VI/7; pj. II, II/VII/8.

146) Pedersen, Alb. T. 65, 45

147) S. Frashëri, *Shqipëria*, 60.

148) Noli, 35.

149) Xoxa, III/130; II/7.

150) Musaraj, Para, II/460.

151) Buzuku, 114/b (Esdra, II, 8/3).

152) Bogdani, pj. I, III/IX/3.

153) Pedersen, Alb. T.; 32.

*bërë për t'u martuar. ...se për të ftohur të bëjnë ata, nuk i njeh ti*¹⁵⁴.
Ti je bërë për të lidhur, Gori Pisha...¹⁵⁵.

ç) ...e tashti tue mos mbetunë më tjetër për të thanë, veçese...¹⁵⁶
Tash' pra jet për t'u shqyrëtuem si është... «Hora resta da vedersi come...»¹⁵⁷; E vetëma gjë, që i mbetej për të bërë, ishte ta qëndronte sulmën e turqve...¹⁵⁸; se u *kishin mbetur* akoma dhe gjashtë të tjerë për të dëgjuar...¹⁵⁹. Tani na ka mbetur për të kërkuar vetëm një ushtar i ditës së parë...¹⁶⁰.

d) ...porse e gjenin këtë zgjedhje fort për të qeshur¹⁶¹.

4) Në fjali të varura krahasore të ndërtuara me lokucionin lidhëzor se sa ose me lidhëzën krahasore se. P.sh.: ...duke theksuar veçanërisht pikën që kjo ishte një luftë për të shpëtuar Shqipërinë nga copëtimi më tepër se sa për të marrë Danjën...¹⁶². Është më shumë për të qarë se për të qeshur¹⁶³.

5) Megjithëse togu foljor në shqyrtim, si rregull, nuk përdoret në funksion kundrinor, sidomos pas foljesh që tregojnë të thënë, të dëshiruar, ai ka filluar të përdoret aty-këtu edhe në këtë funksion, pjesërisht nën ndikimin e ndërtimevet geqe me paskajoren e tipit me punue dhe pjesërisht nga vetë zgjerimi i funksionevet të tij. P.sh.; në të folmen e Nikaj-Merurit: ...nuk mujke për t'i dāl përball¹⁶⁴. Ja edhe disa shembëlla të tjera:

Tërbimi i reaksionit ka arritur deri atje saqë të mos ngurojë për të ndaluar edhe «Lidhjen e invalidëve të rezistencës kombëtare të vjetëve 1941-1944»¹⁶⁵.

6) Ky tog foljor për të njëjtat arësye që u përmendën në pikën 5, ka filluar të përdoret edhe në funksion kryefjalor pas foljesh dhe shprehjesh foljore pavetore, sidomos pas foljevet vjen, mbetet. P.sh.:

Fliste për martesë e i vinte për të qarë. Çupa dëgjonte dhe i vinte për të qeshur¹⁶⁶. ...dhe herë i vinte për të qeshur nga ato fjalë... herë për të qarë...; ...megjithëse i vinte për të vjellë nga ato që lexonte,¹⁶⁷ I mbetej vetëm për të rregulluar çatinë e kosheres.¹⁶⁸ Të gjitha masat e lartpërmendura... janë aqë relative e, ngandonjëherë, aqë subjektive në të zbatuar, sa që nuk është e mundur për t'i disiplinuar me anë kallëpesh.¹⁶⁹

7) Siç e ka vënë në dukje më parë S. Floqi për toskërishten¹⁷⁰, në gjuhën shqipe (duke përfshirë edhe gegërishten) forma e tipit për të punuar përdoret krahas formës vetore të së njëjtës folje në shprehje të tipit për të njohur, e njoh; për të ikur, iku etj.

154) Xoxa, I/170; II/36.

155) Musaraj, Isha unë, 85.

156) Budi, RR, 352.

157) Bogdani, pj. I, I/I/19.

158) Noli, 91.

159) Xoxa, II/172.

160) Kadare, 99.

161) Xoxa, III/63.

162) Noli, 51.

163) Musaraj, Para, I/191.

164) Shih Lafe, «St. fil.» 3, 1964, 129.

165) Shih «Zëri i Popullit», dt. 17.V.1967, f. 4.

166) Xoxa, III/62, I/132.

167) Kadare, 83.

168) Gjata, Përmbysja, 55.

169) B. Dedja, Gaz. «Mësuesi», dt. 5.V.1967, f. 2.

170) Shih BUSHT, SShSh, 3, 1958, 116.

Paskajorja e tipit *për të punuar* e përdorur në ndërtime të këtij lloji shërben për të theksuar më shumë brendinë kuptimore të foljes vetore, para (a pas) se cilës vendoset¹⁷¹: P.sh.:

Për të dëgjuar, kam dëgjuar që Piloja ka shitur dele në pazar. . . *Për të marrë, marrin* nga ne, *për të dhënë s'japin*. Po *për t'u krasitur*, kur *krasiten*? Ajo njohu zërin e Leksit, *po për të parë s'pa njeri*¹⁷². Rexhës mezi i dilte zëri kur fliste. . . ; por *për të qarë nuk qante*, kurse disave prej nesh na shpëtonin lotët. I del gjumi edhe natën, edhe *për të ngrënë* mezi *ha*¹⁷³.

8) Në gegërishte, sidomos në gegërishten veriperëndimore dhe jugore, paskajorja e tipit *për të punue*, e prirë nga paskajorja me *me* e foljes *kam*, përdoret edhe në fjali të varura kushtore. Në raste të tilla ajo mund të zëvendësohet edhe nga paskajorja e tipit *me punue*. P.sh.:

Me pasë për ta marrë ai probatini tjetër të birin e me pre mbi të, kishte m'u njallë prap. . . por për të saktë kishë m'u shndoshë *me pasë për ta mbytë* larojin. . . Baba, *me pasë për të na martue*, më parë më marton mue, qi jam më e madhja. — Po — jau kthen ai — *me pasë për t'u la* me ujë të këtij kroni, kishte m'u shndoshë pa tjetër¹⁷⁴.

9) Si pjesë përbërëse e kohës së ardhme të dëftores dhe e së pakryerës së kushtores, të formuara me pjesëmarrjen e kohës së tashme, përkatësisht të së pakryerës, të foljes ndihmëse *kam*¹⁷⁵. Këto forma perifrastike, që dikur e kanë pasur shumë të theksuar nuançën e detyrimit, sot përdoren edhe pa një nuancë të tillë si sinonime të formave të së ardhmes dhe të kushtores me pjesëzën foljore *do*. Format perifrastike në fjalë, që përdoren më fort në toskërishte, nuk janë të rralla edhe në gegërishte, madje për këtë dialekt dëshmojnë në mënyrë të qartë që në veprën e Bogdanit, p.sh. në veprën e tij (pj. II, I/VII/3) forma e së ardhmes *ka për të ardhunë* është përdorur krahas formës tjetër të së ardhmes *ka me kjanë, ka me shelbyem*.

Ja edhe disa shembëlla të tjera për ilustrim: *Keni për të mbledhë* gjysën e hekurit, që ka ky vend, e keni me ma ndreqë një top me rrfanë . . . I diktoi harusha e si 'i ditë 'i ditë *kishte për t'i shkye* ka dy-tri.«¹⁷⁶ . . . edhe prinzipai do e besonjë atë llaf, edhe më *s'ka për të thën* gjë, edhe do mbetet vajza jote prinzipeshë». ' . . se pa vrarë atë zog nukë *ka për të pushuar* djali, se ai ishtë hje»¹⁷⁷. Mendohenë se [,] po të bëhenë të krishterëtë grekër, myslimanëtë Evropë s'i *ka për të vënë* në vatrë, edhe [,] po të vinjë koha [,] ay vënt, domethënë gjithë Shqipëri e Jugësë e gjithë Toskëria, do t'i epetë Greqisë. Prandaj edhe shqiptarëvet me hir Turqia s'u *ka për të dhënë* gjë. . . pa treguar' ashtu s'ngrihësh dot kurrë,

171) Për përdorimin e ndërtimevet të këtij tipi në rumanishte dhe në gjuhët e tjera romane si edhe në gjuhët sllave shih veprën e cituar të I. Bacinski-t, *L'infinitif*, 41-43.

172) Xoxa, II/247; I/227, 208; II/157.

173) Musaraj, Para, II/501, 15.

174) Kurti, I/50, 68, 108; II/55.

175) Këto forma perifrastike të së ardhmes dhe të kushtores, sipas mendimit tonë, e kanë burimin tek togfjalëshat kallëzuesorë të formuar nga folja *kam* (*kisha*) dhe nga paskajorja e një folje tjetër (shih më sipër pikën 3/b).

176) Kurti, II/118; I/130.

177) Pedersen, Alb. T., 90, 91.

se s'e *kishinë për të lënë*¹⁷⁸. Të jap fjalën e burrit se nuk kam për ta kallzuar Adilin! Po të mos paskish qenë në mes qerrja që i ndante, ...*kishte për ta bërë përshesh*. Edhe sikur të bërtiste, njeri s'*kishte për ta dëgjuar*¹⁷⁹.

B.

11. Togu i gramatikalizuar *me* (ose *një*) + emër prejfoljor asnjanes në kallëzore të pashquar

Siç u vu në dukje edhe në § 9, në gjuhën shqipe përdoren me vlerë foljore edhe togje të formuara nga emra prejfoljorë asnjanes të prirë nga parafjala *me* ose numërori *një*. Por vlerën foljore të këtyre togjeve nuk e kanë pranuar të gjithë studjuesit e shqipes. I pari që e ka përmendur këtë tog është Hani¹⁸⁰, i cili, ashtu si togun e tipit *për të punuar*, e ka quajtur «konstrukt participor».

Dozoni e ka njohur vlerën foljore të togut *me*, kurse atë me numërorin *një* ai nuk e ka trajtuar fare. Dozoni ka shprehur mendimin se togu *me* + emër prejfoljor asnjanes përdoret me vlerën «e një pjesoreje të shkuar ose përcjelloreje, kryefjala e thjeshtë ose komplekse e së cilës, e shprehur ose jo, mund të jetë e ndryshme nga ajo e foljes kryesore»¹⁸¹. Ai shton se ky tog mund të zërthehet me aoristin dhe me një lidhëz. Kështu, sipas tij, *me të ardhurë* është e barabartë me *si erdha, si erdhe* etj.¹⁸².

Pedersen në Alb. T., 22, e përmend edhe togun e ngurosur të tipit *me të folë* (krahas atij të tipit *për të shiturë*) pa u shprehur shkoqur për vlerën e tij. Por nga shënimi «në kuptim pësor» («passivisch»), që jep për konstruktin *me të bërë* hazër djali, ... mund të nxirret përfundimi se ai ndofta e njihte vlerën foljore të këtij togu, të cilin në f. 158 të veprës së tij e quan konstrukt participor, kurse për togun e tipit *një + të dalë* (f. 178) ai nuk jep ndonjë shënim të tillë.

Majeri (Grammatik, 43) ka shprehur mendimin se pjesorja me nyjen e përparme e prirë nga *me*, shërben për të shprehur «njëkohësi» në konstrukthe të tipit *Me të digjuar* këtë motra vajti. Të njëjtin mendim ka shprehur edhe Pekmezi në gramatikën e tij, f. 195.

Cimohovski në veprën e tij *Le Dialecte de Dushmani*, 119-120, thotë se, për të shprehur një veprim të njëkohshëm «me veprimin e kallëzuesit», në të folmen e Dushmanit përdoret «lidhja» e sajuar nga «forma e substantivuar (fem.) e pjesores që ka kuptimin e një nocióni abstrakt»¹⁸³.

Cimohovski shton se në të folmen e Dushmanit përdoret edhe «lidhja» e tipit *me t'ardhun* [me emrin foljor asnjanes — Sh. D.]. P.sh. *Me t'ardhun* në shpi, fillon me ra shi¹⁸⁴.

Cipua, *Sintaksa*, 40, duke bërë fjalë për togun e tipit *me të dëgjuar*, që e quan «lokucion participial», shënon se ky lokucion «mund të zërthehet me aoristin që merr lidhëzën *posa* ose *sapo* në krye». Ai ka shprehur mendimin se edhe togu i tipit *një të dëgjuar* «është baras me lokucionin

178) S. Frashëri, Shqipëria, 40, 66, 61.

179) Xoxa, III/301; I/223; II/19.

180) Vep. cit., II, 88. Do shënuar se Hahn-i e trajton këtë tog njëherazi dhe, me sa duket, si të njëjtë me togun foljor të tipit *me thënë*.

181) Dozon, 314.

182) Dozon, 314.

183) Cimochowski, 120.

184) Po ai, 120.

e sipërmë *me të dëgjuar* dhe që të dy analizohen me anë të aoristit dhe kanë ngahera bashkëkohësi me fjalinë kryesore».

Cipua shton: «Me të njëjtin kuptim të lokucioneve që pamë, kemi edhe lokucionin të *ardhmen* ai, të *ikmen* ai, të *folmen* ai atë fjalë etj. të cilat janë mbiemra foljorë femërorë në rasën kallëzore të çquar. Lokucioni i fundit është më fort trajtë gegërishte».

Xhuvani në studimin *Pjesorja në shqipet*¹⁸⁵, duke bërë fjalë për togun e tipit *me të kënduar*, që ai e kufizon për toskërishten, thotë se ky «lokucioni participor [është — Sh. D.] i analizueshëm në një fjali kohore, që dëftën një veprim të ndodhur në një kohë me veprimin e fjalisë së parë...»¹⁸⁶. Ai shton: «Për të shfaqë një shpejtësi veprimi, ky lokucion formohet, më tepër në toskënishtet, me emnin asnjanes foljor tue i vumë përpara numërorin një: p.sh. *një të kënduar* telegramin u ngrit e doli...»¹⁸⁷.

Xhuvani shton gjithashtu: «Ky farë lokucioni në gegërishtet formohet në rasën kallëzore të gjinisë femënore të mbiemnit participor; p.sh. *të kënduemen* telegramin u ngrit e doli...»¹⁸⁸.

Domi në *Sintaksën* e tij, f. 214, duke bërë fjalë për fjalitë e pashtjella të njëkohësisë, shënon se ato mund të shprehen:

«a) me asnjanesin e pashquar të pjesores të shoqëruar nga parafjala *me* ose fjala *një*: *Një të marrë* notat Gjenci (= posa mori notat), ja shpuri plot gëzim t'et. *Me të mbaruar* mësimet, shkova të loz;

b) me asnjanesin e shquar të pjesores. *Të parët* fëmia se iu afrua qeni (= sapa pa fëmia se iu afrua qeni), ja dha të qarit.

Floqi në studimin «Skicë e së folme së Dangëllisë»¹⁸⁹ i trajton gjithashtu ndërtimet e tipit *një të ardhur* emri, *një të ngritur* e shoqja: unë dua gjakn e burrit. *Me të ryrë* në fshat, gjenë kryetarë e këshillit. Për ndërtimin e parë ai shënon se përdoret për të shprehur «veprim të shpejtë, të pamotivuar»¹⁹⁰, kurse për të dytin shënon se «nuk përdoret kurrë vetëm, por si pjesë përbërëse e dy veprimeve të shikuara nga pikëpamja kohore e pasimit të shpejtë, momentan të veprimit nga veprimi tjetër»; dhe shton se ndërtimet e këtij lloji janë sinonimike «me periudha me fjali të varura kohore, të bashkuara me lidhëzën *sapo*, *posa* etj. Krh.: *Sapo hynë në fshat, gjenë kryetarë e këshillit*»¹⁹¹:

Floqi përmend edhe ndërtimin e tipit *Me të vajtur që ryn në qytet, i del beu*, ku togu *me të vajtur* «s qarohet» me fjalinë e varur *që ryn në qytet*.¹⁹²

Togun e tipit *me të ardhurë* e përmend edhe Hebler për të folmen e arbëreshëve të Selaminës¹⁹³, po pa u shprehur për vlerën e tij gramatikore.

12. Siç e kemi shtjelluar edhe më parë¹⁹⁴, togu *me* † emër prejfoljor asnjanes në trajtë të pashquar në gjuhën shqipe përdoret si një tog

185) Botuar së pari në BShSh 2, 1954, dhe ribotuar më 1956 në përmbledhjen «Studime gjuhësore».

186) «Stud. gjuh.», 209.

187) Po aty, 210.

188) Po aty, 210.

189) Shih BUSHT, SShSh, 3, 1958, 115-116.

190) Po aty, 115.

191) Po aty, 116.

192) Po aty, 116-117.

193) C. Haebler, *Grammatik der alb. Mundart von Salamis*, 152.

194) Shih *Morfologjia*, f. 248-249.

i gramatikalizuar me vlerë foljore. Në bazë të funksionit kryesor të tij (shih më poshtë), ai mund të kategorizohet si një tog foljor me vlerë participore. Kuptimi kohor i këtij togu është i kushtëzuar nga kuptimi kohor i foljes së fjalisë drejtuse. Kur folja e fjalisë drejtuese është në të kryerën e thjeshtë¹⁹⁵, ose në të tashmen historike, veprimi i shprehur prej togut në shqyrtim është një veprim konkret i veçantë, që ka marrë fund në të shkuarën; në këtë rast ai mund të zëvendësohet me formën përgjegjëse të së kryerës së thjeshtë të prirë nga një prej lidhëzavet nënrenditëse kohore *sa, posa, sapo*¹⁹⁶. Kur përdoret kështu, togu në shqyrtim, bashkë me fjalët e tjera të lidhura me të, ka vlerën e një fjalie të varur kohore. P.sh. ... edhe *me të ikurë* kali [,] [mbreti] *hodhi* sytë në ujë... *Me të parë* mbreti çupën e tij [,] *porositi* në gjithë mbretëri të bënin... *Me të parë* prapë e rrëmben edhe *ngrihet* me gjithë të kaqë lart sa s'dukej¹⁹⁷. *Me të afëruarë* afërë kasabasë, i *thotë* kapetani djalit... E bukur e dheut *me të digjuarë* zën' e birbilit, eftis *dërgoi* e e *shtroi* me cohë (bohasi) të kuqe... *Me të folë* djali, *zuri* birbil gjizari e këndon...¹⁹⁸ *Me të parë* shqipëtarëtë gjuhën' e bukurë të tyre të shkruar- aqë mirë, e *zunë* shkronjatë me të dy duartë...¹⁹⁹ *Me të buçitur* krisma e fundit, ... ajo *pa* se si po fluturonte majë kali... Sabri Kalamatreshi. *Me të ndjerë* Vita në buzë njomësinë dhe ëmbëlsinë e verës, *hapi* sytë²⁰⁰. *Me të dëgjuar* këtë emër, djali *u verdh*... *Me të njohur* zërin, Bimi *u ngrit* rrëmbimthi ... *Me t'u hapur* dera... të gjithë kthyen kryet andej²⁰¹. *Me t'ardhun* n'shpi *fillon* me ra shi. *Me t'dalun* prej shpijet²⁰².

Kur folja e fjalisë drejtuese është në kohën e ardhme²⁰³, ose në mënyrën urdhërore a në të tashmen e lidhore (me kuptim urdhëroreje), atëhere veprimi i shprehur prej togut është gjithashtu një veprim konkret i veçantë, që pritet të vërtetohet në të ardhmen. Por, kur folja e fjalisë drejtuese është në kohën e ardhme, atëhere togu në fjalë mund të tregojë edhe një veprim që pritet të përsëritet në të ardhmen. Në të dy rastet togu me vlerë foljore mund të zëvendësohet me formën përgjegjëse të së tashmes lidhore të prirë nga një prej lidhëzavet nënrendi-

195) Në vend të së kryerës së thjeshtë (dhe në kuptimin kohor të saj më ndonjë të folme geqe mund të haset koha e kryer, P.sh. *Me t'ramen* n'pazar *ka bumullue*. *Me t'hymen* n'shpi *ka ra rrejeja* (Cimochowski. 119).

196) Togu në fjalë mund të përdoret edhe me kuptimin kohor të më se të kryerës (plus quam perfectum), në rast se folja e fjalisë drejtuese është në më se të kryerën e dëftores. P.sh. Edhe Piciruku e Rexha, që, si të qarkorit, duhej të ishin pak a shumë më të informuar, kishin ardhur në mbledhje drejtpërdrejt nga Peza bashkë me të deleguarit e tjerë dhe s'mund të çfaqnin asnjë mendim, ndërsa një numër i madh ilegalësh, kryesisht përgjegjës celulash, që vinin nga Tirana, *ishin nisur me të marrë* lajmin dhe s'kishin patur kohë të takoheshin me asnjë nga shokët e qarkorit. (Musaraj, Para, II/232-3).

197) Dozon, 21, 30-31, 30.

198) Pedersen, Alb. T., 22-23, 35, 35.

199) S. Frashëri, Shqipëria, 47.

200) Xoxa, II/85; I/131.

201) Musaraj, Para, I/485, 250; II/478.

202) Cimochowski, 120.

203) Kur folja e fjalisë drejtuese është në kohën e ardhme në të shkuarën (e cila formalisht del njësoj me kushtoren), atëhere edhe togu në fjalë ka kuptimin e një së ardhmeje në të shkuarën dhe mund të zëvendësohet me të pakryerën e lidhore. P.sh. Qante e ëma edhe ulërinte, *se me të vatur* djali saj te asllani, *to t'i derdhej* edhe *to ta bënte* njëmijë copëra... (Dozon, 55). Zoti Ajët e dinte... *se Qemali...* *me të shikuar* gjermanin e parë në prag të portës, *do t'i vërsulej* me bomba (Musaraj, Para, I/493).

tëse kohore *sa, posa, sapo*; si rrjedhim bashkë me fjalët e lidhura me të, ai përdoret në funksionin e një fjalisie të varur kohore. P.sh.:

a) Nukë di që *me të parë* ty ay, *to të derdhet* të të hajë? ²⁰⁴ e *me të vaturë* ne sufra i tij, *të zdrigjeç* e *të haç*. . . ²⁰⁵

b) Edhe asllani i tha: «Më vërtet to të jap florinë edhe ti të më siellç tainë, po dashuria jonë të jetë këtu e tutje lark nga neve, se edhe ti *me të parë* varrin e djalit këtu, *to të më mallëkonç* edhe *to të më mërziç*, edhe *to të të dridhet* zemëra. . . » ²⁰⁶ Të xgjedhuritë [,] *me të mbledhurë* [,] *do të xgjedhinë* në mest të tyre një krye edhe një nënëkrye. *Me të shkelurë* më të njëzetat, *do të hynjë* n'ushtërit të mësimi për një mot vetëm ²⁰⁷.

Kur folja e fjalisë drejtuese është në të pakryerën e dëftores, atëhere togu në shqyrtim tregon një veprim që është përsëritur në të shkuarën. P.sh.:

Me t'i parë nga larg, njerëzit *ndërronin* udhë, ose *shtrengoheshin* trotuareve, si për t'i shpëtuar vështrimit të ftohtë prej sysh të vdekuri të rojeve të murme. Orzestë italianë! Edhe 20 vetë bashkë të ishin, *me të parë* një SS, që u drejtohej, *u merreshin* sytë si pulave nga kunavja dhe *bënin* si u thoshte ai me shënja. Gra e burra, që dilnin nga shtëpitë për në punë të tyre, *me të parë* se ç'po ndodhte, *ktheheshin* me nxitim për vëndi, por ballistët u drejtonin pushkët. . . Atë mbrëmje Ferikun s'e zuri gjumi menjëherë, siç e *zinte* zakonisht *me të vënë* kokën në çantën e shpinës ²⁰⁸.

Kur folja e fjalisë drejtuese është në të tashmen e dëftores dhe ka një kuptim kohor të pacaktuar, atëhere edhe togu në shqyrtim tregon një veprim me kuptim kohor të pacaktuar ose një veprim që përsëritet herë pas here. P. sh.

Kufit' e veriut të Shqipërisë, *me të ndarë* nga an' e detit [,] *ngjitenë* drejt veriut. . .; një grek, për pasqyrë, *me të ndruarë* besënë [,] *le* edhe kombësinë. . . ²⁰⁹

Shënim 1. — Në shprehjen popullore «*Me të parë* e *me të bërë*» (shih, p.sh. Musaraj, Para, II/343), janë bashkërenditur dy togje emrash prejfoljorë të prirë nga pafjala *me*; këta janë të barasvlershëm me shprehjen «shohim e bëjmë».

Shënim 2. — Në veprën e S. Frashërit «Shqipëria ç'ka qënë. . .» e gjejmë të përdorur disa herë një tog foljor të këtij tipi në ndërtime të barasvlershme me një fjali të varur shkakore ose mënyrore. Në këto raste, sipas mendimit tonë, kemi të bëjmë me një përdorim vetjak të Samiut. P.sh.

Me të mos shkruarë gjuhën' e tyre[,] janë shtrënguar të shkruajnë greqisht, llatinisht, shqahisht, tyrqisht a arabisht. . . Myzeqeja *do të bëhetë* një ar' e gjer'e e gjatë [,] e cila [,] *me qënë* nën ujë e *me të pasurë* një dhe fort pëllor, *do të bëhetë* një Egjipt'e dytë... të cilatë, *me të mos mundurë* t'i godinjë vetë, *do t'ia dërgonjë* nënëqeverisë²¹⁰.

. . . Shqipëtarët e kanë mbajturë gjuhën' e kombësin' e tyre jo me

204) Dozon, 55.

205) Pedersen, Alb. T., 39.

206) Dozon, 56.

207) S. Frashëri, Shqipëria, 73, 74.

208) Musaraj, Para, I/433, 190; II/43, 148.

209) S. Frashëri, Shqipëria, 25, 36.

210) S. Frashëri, Shqipëria, 21, 80, 88.

shkronja as me dituri as me qytetëri, po vetëm me dliri, *me të qënë* gjithënjë vetëm e me vetëhe, *me të mos përzjerë* me të tjerë e *me të mos kallurë* të huaj në vëndit të tyre. Janë njëzet vjet, në kohët të lidhjes' së Pizrenit, u bënë shkronjatë shqip të plota e të mbaruara *me të pasurë* çdo shkronjë vetëm një zë edhe për çdo zë një shkronjë më vetëhe²¹¹.

Siç shihet, ky tog foljor në shëmbëllat e mësipërme është përdorur me vlerën e përcjellores²¹².

C.

13. Togu i gramatikalizuar një + emër foljor asnjanes në kallëzore të pashquar

Edhe togu i tipit *një + të ardhur* përdoret shpesh në gjuhën e folur (e më rrallë në gjuhën e shkruar) me vlerë foljore, për të shprehur veprime, që ndjekin njëri-tjetrin me shpejtësi. Kur përdoret kështu, ky tog, ashtu si ai i tipit *me + të ardhur*, ka vlerën e një ndërtimi participor. Ky tog me vlerë participore mund të përdoret:

1) Me vlerën e një fjali të pavarur; në këtë rast ndërtimet e këtij tipi bashkërenditen njëri pas tjetrit me anë të lidhëzës këpujore e (ose *dhe, edhe*), ose asidentisht. Në raste të tilla ndërtimet në fjalë kanë vlerën kohore të së kryerës së thjeshtë. P.sh.

Një të ardhur emri, *një të ngritur* e shoqja: Unë dua gjakn e burrit. *Një të rënë* birbilit, *një të pështjellë* rreth përçark. *Një të thënë*, *një të vajtur*²¹³. *Një t'i hipur* qerres neve / një ta marrë dhe Nasin me vefte, dhe, o burra, n'Seman për tër natën me gjith t'vdekurin. *Një t'thënë* dhe *një t'bër*²¹⁴. *Një të marrurë*, *një të nisurë*. *Një të vatur* e *një të bluuar* miell. *Një të ardhur* ata dhe *një të rrëmbyer*. *Një të ngrit* dhe *një të ikur*, kur u gdhi sabau²¹⁵. *Ni t'vot* ke aj krali n'kala t'Döds, *ni t'mar* cucën. *Ni t'pre* drumin e *ni t'marr* kualt²¹⁶. Ashkosun, o Leks, *një të ikur* unë nga shtëpia e *një t'u çthurur* gardhi²¹⁷.

2) Me të njëjtën vlerë (si në pikën 1) përdoren ndërtimet e këtij tipi edhe kur bashkërenditen (me ose pa lidhëzën këpujore) me një fjali të pavarur, kallëzuesi i së cilës është një folje në të kryerën e thjeshtë. Fjalja në fjalë mund të ndodhet para ose pas konstruktit participor, i cili në këtë funksion mund të përdoret edhe bashkë me të kryerën e thjeshtë të foljes *bëj*, formalisht si kundrinë e drejtë e kësaj, por kuptimisht i gjithë togfjalëshi (*bëri + një + emër prejfoljor asnjanes*) është i njëvlerëshëm me të kryerën e thjeshtë të foljes, prej së cilës është formuar emri prejfoljor asnjanes. P.sh.

211) Po aty, 17-18, 47.

212) Naimi në raste të tilla përdor formën perifrastike të tipit *me qënë*, gjithnjë me vlerën e përcjellores. P.sh.: Po hëna, *me mos pasurë* ujëra e *me qënë* shumë m'e vogëlë nga dheu, duke plasurë (cip's saj shumë herë, iu mbarua zjarri. (Rev. «Drita», II/23). Dheu, *me qënë* m'i math se hëna, thëthiti ujërat' e erënë hënësë (Dituritë, 6).

Për përdorimin e kësaj forme tek Naimi në fjali të varura me funksione të tjera sintaksore shih Demiraj, BUSHT, SSHSH, 1, 1959, 50-51.

213) Shih Floqi, BUSHT, SSHSH, 3, 1958, 115.

214) Shih Thomaj, BUSHT, SSHSH, 4, 1961, 135.

215) Shih Totoni, FZ, BUSHT, SSHSH, 1, 1962, 206.

216) Shih Haxhihasani, BUSHT, SSHSH, 4, 1963, 138. Për një përdorim të tillë shih edhe M. Çeliku, VFK, Stud. fil. 3, 1966, 101.

217) Xoxa, Lumi, III. 130.

... edhe *një të dalë* çifuti edhe iku, më s'qëndroi atje. ... ajo loi *sa* loi edhe *një t'ikur bëri*, që nonjë s'e kuptoi, se kur iku. ... një të lëshuar *i bëri* lepurit edhe vete në punë të tij. — ... *një të friturë bëri* kali edhe kërceu djali mbërnda në kazanë²¹⁸. Ajo fëllënxa e nxorri kokën dhe e zuri pikën e mjalitit; macja *një të këputur* kokën e fëllënxës²¹⁹. ... Vajti njer në mest, e pa ajo dhe *një të prer e bëri* litarr. ...²²⁰ Po ai kukullën e quan Penamurfin; edhe *një të mar* thikën, edhe ja nguli në grik. ... vari kungullin me hi më një lis, i gënjejtë dhe *një t'ikur bëri*. Ja dha ai, e bleu, vete në shtëpi, *një t'i therur* gruan e fëmilën që t'i ngjadhte. ...²²¹.

3) Me vlerën e një fjalie të varur kohore, që plotëson kuptimin e një fjalie tjetër, kallëzuesi i së cilës është një folje në të kryerën e thjeshtë (ose në të tashmen historike me vlerën e së kryerës së thjeshtë). Edhe në këtë funksion kuptimi kohor i këtij ndërtimi participor, i kushtëzuar nga ai i foljes së fjalisë drejtuese, i referohet së shkuarës, prandaj ai edhe mund të zëvendësohet me të kryerën e thjeshtë të prirë nga lidhëzat *sa, sapo, posa*, P.sh.:

Një t'i çuor ujt zjarrit qy, u shua zjarri²²². *Një të zënur* atë djalë, e prunë në përrua. *Një të dalur* Zheotë, i vunë dufeknë²²³.

14. Siç del edhe nga shëmbëllat e mësipërme, togjet e tipit *me + të ardhur* dhe *një + të ardhur* formohen me pjesëmarrjen e atyre emrave prejfoljorë asnjane, të cilët, ashtu si foljet përkatëse, emërtojnë veprime fizike ose psikike-fiziologjike. Secili nga këto togje përdoret për të shprehur një veprim të shpejtë, që ndiqet menjëherë nga veprimi i shprehur prej foljes së fjalisë drejtuese.²²⁴

Gjithashtu do shënuar se këto togje me vlerë foljore, që janë karakteristike për stilin tregimtar, përdoren më shumë në të folmet jugore, por nuk janë të rralla edhe në të folmet geqe. Togu i tipit *një + të ardhur* përdoret relativisht dëndur në të folmet e gegërishtes jugore. Kurse togu i tipit *me + të ardhur* (geg. *me t'ardhun*), dëshkohet për të folmen e Dushanit,²²⁵ në Shqipërinë Veriore, si edhe për të folme të tjera geqe,

* * *

Në të folmet geqe, ku ndjenja e gjinisë asnjane gjatë këtyre shekujve të fundit është dobësuar shumë dhe forma asnjane e emrave prejfoljorë është zëvendësuar nga forma femërore,²²⁶ në këto togje emri prejfoljor përdoret më fort në formën e gjinisë femërore. P. sh.

Me t'ramen n'pazar, *kā* bumullue. *Me t'hjmen* n'shpi [,] *ka* ra rrefta²²⁷.

218) Shih Pedersen, Alb. T. 172.

219) Shih Floqi, BUSHT, SSHSH, 3, 1958, 115.

220) Gjinar, FM, BUSHT, SSHSH 4, 1958, 106.

221) Totoni, FBP, II, St. fil., 2, 1964, 137; VFM, St. fil., 3, 1965, 120; VFQGG, St. fil., 1, 1961, 115.

222) Thomaj, BUSHT, SSHSH, 4, 1961, 135.

223) Totoni, FZ, BUSHT, SSHSH, 1, 1962, 206.

224) Natyrisht veprimi i shprehur nga togu i tipit *një + të ardhur* ndjek atë të foljes së fjalisë, pas së cilës ai është bashkërenditur.

225) Cimochofski, 120.

226) Çështjen e dizintegritit të gjinisë asnjane e kemi trajtuar në një punim tjetër ende të pabotuar.

227) Cimochofski, 119.

Sipas një kumtimi të arësimitarit Mufit Trepça, në të folmen e Peshkopisë dhe të fshatrave të asaj ane janë të rëndomta ndërtimet e tipit: Ni *t'ardhme*, kam me ia thanë.

Edhe M. Çeliku²²⁸ përmend ndërtime të këtij lloji për të folmet e Shpatit, Dumresë, Elbasanit, e Peqinit. P.sh.: ... aj i *t'thanme*, i bëni mas florit pula (Shpat) *I t'shkueme* qi shkon atje, ra n'burk (Dumre), *I t'kapme* qi e kapi, u përvlu na durët (Elbasan). *I t'ranme* qi ra, s'u përmën ma (Peqin).

15. Gjithashtu do pasur parasysh fakti i vënë në dukje edhe nga gjuhëtarë të tjerë²²⁹ se në të folmet gege në vend të togut të tipit *me t'ardhun* a *me t'ramen*, gjatë këtyre shekujve të fundit ka ardhur duke u përdorur gjithnjë e më shumë forma e kallëzores së shquar njëjës të emrit prejfoljor të gjinisë femërore pa parafjalën *me*, e cila sipas mendimit tonë, duhet të ketë rënë²³⁰. Emri prejfoljor i gjinisë femërore, i përdorur kështu në një ndërtim të barasvlershëm me një fjali të varur kohore, jo vetëm kuptimisht por edhe gramatikisht ka ardhur duke u larguar gjithnjë e më shumë nga klasa e emrave dhe duke iu afruar klasës së foljevet. Kuptimisht ai është i njëvlershëm me togjet e tipit *me + të ardhur* dhe *një + të ardhur*. Kjo ka bërë të mundur që ai të marrë edhe kryefjalë si edhe trajta të shkurta në funksion kundrinor (ose si përsëritje kundrinash), duke u vendosur këto midis nyjes *të* dhe temës participore të tij. Gjithashtu nuk janë fort të rralla rastet e përdorimit të këtij emri prejfoljor të gjinisë femërore edhe me pjesëzën *u* të diatezave të pësore-vetëvetore. P.sh.

N'vakt moçm kishte ken adet n'nji shehr, qi *t'u plakmen* i zoti shpis, kishte për ta mar i biri me e çue e me e myt n'uj²³¹. *T'i ndiemën* thiu këto fjalë, shkoi e e thei mzuçken për shkam. Grueja, *ta pamen*, bân me hî në breshkë. *Ta vûmen* fmiija at rreth në gisht, u rrit as t'ishte njizet vjeç. Kam me ia çue neser *të dalmen* drita... pse *t'i pamen*, bâhet nieri

228) Çeliku, Togje foljore; BUSHT, SSHSH 1, 1963, 171.

229) Shih Cipo, Sintaksa, 40; Xhuvani, Studime gjuhësore, 210.

230) Sipas një kumtimi të studentit Mehmet Elezi nga katundi Margegaj i Tro-pojës, në të folmen e asaj zone përdoren jo rrallë ndërtime të këtij tipi me emrin prejfoljor në gjininë asnjane, si p.sh.; *T'çelunit dera*, [ajo] po e kthe kryet n'njan'anë, tuj kujtue se po i vje djali. Edhe tek Mitkua hasen ndërtime të këtij tipi me emra prejfoljorë asnjane në trajtë të shquar pa ndonjë parafjalë, por nuk jemi të sigurtë në kemi të bëjmë në këtë rast me ndërtime popullore. Ja disa shembëlla:

Të marrët mjeku djalin, e shpuri në shtëpi të tij...; Po djali, *të parët* se ay iu afërua, siç e mësoi plaka, hodhi përpara gurin e krypës:.. (f. 177).

Po tek Mitkua emrin prejfoljor asnjane në trajtë të shquar në ndërtime të këtij lloji e gjejmë edhe të prirë nga parafjala *me*. P.sh. *Me të vaturit* nd'atë fshat ay, ra ndë shtëpi të një plake. *Me të kulturët* atë adha ndë një vënd, kaha ku me zi i pa glishtin vetëm asajë, sakaqë i rëmbyen florinjte... (f. 179). Me të njëjtin funksion Mitkua përdor ndonjëherë të ashtuquajturën përcjellore, siç na dëshmon kjo shembëll: E djali, *tuke parë* këtë punë të prapë, u ngas, edh' ua çkëmbëu të ngrënë (f. 177). Edhe Camarda, Saggio, 269, 329, thotë se emri prejfoljor asnjane i prapanyëzuar «shërben si pjesore absolute: të thënë të këta, «detto questo», duke u nënkuptuar ndofta një parafjalë». Përsa i takon përdorimit të nyjes shquese të kallëzores (-n, përkatësisht -t a -të), kjo është bërë e domosdoshme në këtë rast nga mungesa e parafjalës dhe e ndonjë fjale përcaktuese (si n'ya *një*, ose ndonjë përemër). Në gjuhën shqipe emrat mund të përdoren në rasën kallëzore të pashquar njëjës, pa qenë të prirë nga ndonjë fjalë përcaktuese, zakonisht, vetëm kur përdoren në funksion kallëzuesor.

231) Jarnik, 10.

gur²³². Sa t'bajë dritë, ka ndoren dielli; *T'errmen* natë, /ka ndoren ha-na²³³... Këndoni, këndon. Veç prej stanit/ *t'ardhmen* Trina mbramje n'shpië, /tui blegrue një kij mbas zanit/ t'deles nanë keni me ndie./²³⁴.

D.

16. Rreth formimit të togjevet në shqyrtim

Përsa i takon mënyrës se si janë krijuar togjet me vlerë foljore në shqyrtim, duhet sqaruar më parë në kemi të bëjmë me kalkime nga gjuhë të tjera të Ballkanit, të cilat, siç dihet²³⁵, gjatë zhvillimit historik të tyre kanë krijuar gjithashtu togje të tilla. P.sh., siç u vu në dukje edhe në § 6, si në shqipe ashtu edhe në rumanishte emri prejfoljor i prirë nga parafjala *për*, përkatësisht *de*, *pentru* etj, përdoret si një tog i ngurosur me vlerë paskajoreje. Sandfeldi shënon se konstruktet e formuara nga një emër foljor i prirë prej numërorit *një* përdoren «në vend të një fjalie kohore» në gjuhën shqipe, në maqedo-bullgarishte si edhe në aromunishte. Për këto dy të fundit ai jep shëmbëlla të tilla si: (maq. bullg.) edno vlegvenje v'odaa-ta, si izva'il pârsten-ot ot pârst-ot «dès qu'il fut entré dans la chambre, il ôta l'anneau du doigt» etj. (Arom.) ună intrare tu piscireauă, zina aça ma marea zisse «dès qu'elles furent entrées dans la grotte, l'aînée des fées dit»: ...ună turnată barbatu-su, acată s plângă «dès que son mari fut de retour, elle se mit à pleurer»²³⁶.

Gjithashtu Sandfeldi shënon se konstrukti i formuar nga një emër prejfoljor i prirë prej parafjalës *me* (p.sh. *me të dëgjuar*) haset edhe në greqishte, për të cilën jep shëmbëllën: με τό παλινωμά του σε μιὰ μείαλε βρύση, βλέπει ένα κυριόφιδι «en arrivant à une grande fontaine, il voit un grand serpent». Ai shton se edhe në aromunishte haset nganjëherë parafjala *cu* «me» në konstruktet të tilla si: cu ună mîngare, crescură trei coarne. «une fois qu'elle eut mangé, trois cornes poussèrent»²³⁷.

17. Konkordanca shqiptare-rumune e tipit *për të bërë*, përkatësisht *de făcut*, do parë në një kuadër më të gjërë. Ajo do parë në lidhje të ngushtë me faktin që si në shqipe ashtu edhe në rumanishte emri prejfoljor, duke u përdorur edhe me kuptim vepror²³⁸, ka bërë të mundur krijimin e këtyre togjeve me vlerë paskajoreje. Por formimi i vetë këtyre togjeve në shqipe e në rumanishte, sipas mendimit tonë, do parë më fort si një zhvillim paralel i këtyre dy gjuhëve. Ne nuk dimë se kur do të jetë formuar togu rumun i tipit *de făcut*. Por fakti që elementet përbërëse të tija nuk janë shkrirë në mënyrë të tillë që të sajojnë një formë gramatikore të mirëfilltë, nuk flet për një lashtësi të madhe të tij. Nga ana tjetër, edhe togu me vlerë foljore i tipit *për të punuar*, megjithëse duhet të jetë mjaft i vjetër²³⁹, nuk mendojmë të jetë sajuar që në kohën kur ekzistonin kontakte të drejtpërdrejta midis shqipes e rumanishtes.

232) Kurti, I/12, 29, 85, 13; II/103.

233) K P L, 158.

234) Mjeda, Juvenilia, 32.

235) Shih Sandfeld, 122-124, 130-132.

236) Po aty, 123.

237) Po aty, 124.

238) Shih § 5.

239) Për vjetërsinë relative të këtij togu me vlerë foljore në shqipe nuk flet vetëm ekzistenca e tij në të gjitha të folmet e shqipes, duke përfshirë edhe ato të arbëreshëve të Greqisë e të Italisë, por edhe plurifunksionaliteti i tij.

18. Përsa u takon togjevet të tipit *një të dalë, me të dëgjuar* dhe konstruktivet përgjegjëse të maqedo-bullgarishtes, aromunishtes dhe greqishtes, Sandfeldi këto i radhit midis konkordancave ballkanike, për të cilat «është vështirë të përcaktohet pika e nisjes»²⁴⁰.

A. Filippide ka shprehur supozimin se ndërtimi aromun i tipit *unë intratë* ndofta është formuar nën ndikimin e ndërtimevet të tipit *një të hyrë* dhe *me të hyrë* të shqipes²⁴¹.

Lidhur me konkordancën midis shqipes, maqedo-bullgarishtes dhe aromunishtes, të cilat përdorin togje me vlerë foljore, të formuara nga emra prejfoljorë të prirë prej numërorit *një*, pika e nisjes, sipas mendimit tonë, do kërkuar në gjuhën shqipe. Në të mirë të kësaj teze flasin qartë këto fakte:

1) Ky tog me vlerë foljore është i mbarë shqipes popullore, si në veri edhe në jugë²⁴², pra, duhet të jetë relativisht i vjetër.

2) Fakti që ky tog me vlerë foljore, sipas Sandfeldit, haset vetëm në maqedo-bullgarishte, por jo në bullgarishten e mirëfilltë, si edhe vetëm në aromunishte, por jo në dako-rumanishte²⁴³, flet qartë për risinë e tij relative në maqedo-bullgarishte dhe aromunishte.

3) Këto dy rrethana si edhe fakti që si maqedo-bullgarishtja ashtu edhe aromunishtja kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm me shqipen, të bëjnë të anosh nga mendimi që ky tip konstruktiv në maqedo-bullgarishte dhe në aromunishte është kalkuar prej shqipes.

19. Përsa i takon konkordancës së invokuar nga Sandfeldi ndërmjet konstruktiv shqip të tipit *me të dëgjuar*... dhe konstruktiv grek të tipit *με τό παλινωμά του*, do pasur parasysh se këtu nuk kemi të bëjmë me të njëjtin tip ndërtimi. E vetmja gjë e përbashkët në këtë rast është të përdorurit e parafjalës *me* (gr. *μέ*) para një emri prejfoljor asnjanes në ndërtime me vlerë kohore²⁴⁴. Por ndërtimi grek nuk ka marrë tipare gramatikore foljore, siç janë ato të ndërtimit shqip - të përdorurit me kryefjalë e kundrina (këto të fundit mund të shprehen edhe me anë trajtash të shkurta) si edhe të përdorurit me pjesëzën përemërore *u* të diatezavevet pësore-vetëvetore²⁴⁵. Konstruktiv grek, në të cilin emri prejfoljor asnjanes, i formuar me prapashtesën *μα*, ndiqet nga një përemër pronor ose nga një emër (në rasën gjindore) me vlerën e plotësit kryefjalor, do t'i përgjigjej në shqipen e sotme konstruktiv *me + emër prejfoljor* (me prapashtesën *-je* ose *-im*) i ndjekur nga *një përemër a emër në gjindore* (ose një *mbiemër pronor* në rasën kallëzore). P.sh.: Me vdekjen e Lek Zaharisë, ... principata e Danjës mbeti pa zot²⁴⁶.

Përsa i përket konstruktiv aromun të tipit *cu unë mîngare*, crescură trei coarne, duket qartë që këtu kemi të bëjmë me konstruktiv e tipit *unë intrare* (shih më sipër) të përforcuar me parafjalën *cu (=me)*, me sa duket, nën ndikimin e shqipes a të greqishtes.

Në dritë të këtyre fakteve nuk mund të mos nxirret përfundimi se togu me vlerë foljore i tipit *me + emër prejfoljor asnjanes në trajtë të pashquar* është një formim i brendshëm i shqipes. Pas mendimit tonë,

240) Sandfeld, 122.

241) Shih A. Philippide, Originea Romînilor, 442, 616.

242) Shih § 14.

243) Shih A. Philippide, vep. cit., 434, 442.

244) Shih § 12.

245) Shih § 9.

246) Noli, 50.

ky tog duhet të jetë relativisht i vjetër në shqipe. Për vjetërsinë e tij relative flet qartë si ekzistenca e tij edhe në të folme të arbëreshëvet të Greqisë²⁴⁷, ashtu edhe përhapja e tij gjeografike brenda Shqipërisë. Ky tog me vlerë foljore, që është aq i shpeshtë në të folmet jugore, haset edhe në të folme të Shqipërisë Veriore, si p.sh. në të folmen e Dushmanit²⁴⁸ e gjetkë. Por si ky tog ashtu edhe ai i tipit *një të dalë* janë, pa tjetër, të një moshe më të re se togu i tipit *për të punuar*, i cili jo vetëm që përdoret në të gjitha të folmet e Shqipërisë e gjendet edhe tek autorët e vjetër veriorë, por haset edhe në të folmet e arbëreshëvet të Greqisë²⁴⁹ e të Italisë²⁵⁰. Për vjetërsinë më të madhe të togut të tipit *për të punuar* flet qartë edhe të përdorurit e tij me funksione të ndryshme sintaksore²⁵¹.

Por gramatikalizimi i togjevet të tipit *për të punuar*, me të dalë dhe *një të dalë* është pa tjetër më i ri se gramatikalizimi i togjevet të tipit *me qenë*, *pa qenë*, *duke qenë*, tek të cilët elementi i dytë ka qenë një pjesore e substantivuar²⁵².

20. Formimin e togjeve me vlerë foljore të tipit *për të punuar* dhe *me të dëgjuar* nga togjet e lira përgjegjëse e kanë bërë të mundur këto fakte gjuhësore:

1) Emri prejfoljor asnjanes në gjuhën shqipe, siç e kemi shtjelluar edhe në § 4-7²⁵³, për nga kuptimi afron shumë me paskajoren.

2) Ky tip emrash pas parafjalëvet, që ndërtohen me rasën kallëzore, përdoret zakonisht në trajtë të pashquar²⁵⁴.

Në të tilla rrethana emri prejfoljor asnjanes në togjet e këtij tipi me kohë i ka humbur tiparet emërore dhe ka ardhur duke marrë gjithnjë e më shumë tipare foljore.

* * *

Përsa i takon togut me vlerë foljore të tipit *një + të ardhur*, sipas mendimit tonë, ky në krye të herës do të jetë përdorur në stilin e bisedës tregimtare për të shprehur veprime të së shkuarës, që kanë ndjekur njëri-tjetrin me shpejtësi (Shih më sipër § 13, pika 1). Duke u përdorur kështu me vlerën e së kryerës së thjeshtë, me kohë u bë e mundur që togu në fjalë të përdorej edhe i ndjekur (ose i prirë) nga një fjali e bashkërenditur (me ose pa lidhëzën këpujore *edhe*) me kallëzues një folje në të kryerën e thjeshtë (shih § 13, pika 2). Kjo duhet konsideruar si një fazë e ndërmjeme, që me kohë bëri të mundur përdorimin e këtij togu në funksionin e një fjalie të nënrenditur me vlerë kohore (shih § 13, pika 3).

247) Shih Haebler, 152.

248) Shih Cimochoowski, 120.

249) Tek Reinhold-i, Leks. 48 gjejmë: plëhurë *për të pushtuarë* panikotënë. Gjithashtu tek Haebler, Gramm. 152, gjejmë: Karavi ish *për të mbarturë*; plaku ish *për të vdekurë*.

250) Shih kumtesën tonë në Konferenca 1, 219.

251) Shih § 10.

252) Shih edhe § 7, shën. 58.

253) Shih edhe kumtesën tonë në Konferenca 1, 219.

254) Shih Pedersen, Bidrag, 255.

Shih edhe kumtesën tonë në Konferenca I, 220.

VEPRAT DHE ARTIKUJT E CITUAR

- Bacinski Ilie**, *L'infinitif et les moyens de son remplacement*, Bucarest, 1946.
- Brincus Grigore**, *Genul neutru în albaneza*, SCL (Studii și cercetări lingvistice), 1963, nr. 1.
- Camarda Demetrio**, *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Livorno, 1864.
- Cimochowski Waclaw**, *Le dialecte de Dushmani*, Poznan, 1951.
- Cipo Kostaq**, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949.
- Cipo Kostaq**, *Sintaksa*, Tiranë, 1952.
- Çabej Eqrem**, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*. VI, BUSHT, SShSh, 1962, nr. 1.
- Çabej Eqrem**, *Betrachtungen über die rumänisch-albanischen Sprachbeziehungen*, «Revue roumaine de linguistique», T. X. 1965, nr. 1-3.
- Çeliku Mehmet**, *Disa togje foljore në shqipen e sotme*, «BUSHT, SShSh», 1963, nr. 1.
- Çeliku Mehmet**, *Vëzhgime mbi të folmen e Kërrabës*, «Stud. fil». 1966, nr. 3.
- Da Lecce, Fr. M.** *Osservazioni grammaticali nella lingua albanese*, Roma, 1716.
- Demiraj Shaban**, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe* (dispensë e botuar nga USHT), Tiranë, 1962.
- Demiraj Shaban**, *Disa shënime rreth lëvrimit të gjuhës shqipe gjatë shek. XIX*, «BUSHT, SShSh», 1958, nr. 4; 1959, nr. 1.
- Demiraj Shaban**, *Forma grammatikore perifrastike për + emër foljor i gjinisë asnjansë në trajtë të pashquar*. (Botuar në vëllimin «Konferenca e parë e studimeve albanologjike». Tiranë, 1965).
- Demiraj Shaban**, *Rreth disa problemeve të paskajores në gjuhën shqipe*, «Stud. fil». 1969, nr. 1.
- Domi Mahir**, *Morfologjia historike e shqipes* (dispensë e botuar nga USHT), Tiranë, 1961.
- Domi Mahir**, *Gramatika e gjuhës shqipe. Pjesa e dytë — Sintaksa* (tekst për shkollën shtatëvjeçare), Tiranë, 1955.
- Dozon August**, *Manuel de la langue chkiye ou albanaise*, Paris, 1879.
- Floqi Spiro**, *Skicë e së folmes së Dangëllisë*, «BUSHT, SShSh», 1958, nr. 3.
- Frashëri Sami**, *Shkronjëto e gluhësë shqip*, Bukuresht, 1886.
- Gabinskij Mark**, *Vozniknovenije infinitiva kak vtoričnyj ballkanskij jazikovoj process*, Leningrad, 1967.
- GLR**, *Gramatica limbii romine* (editura Republicii Populare Romine) vëll. I (ediția a doua). București, 1963.
- Gjinari Jorgji**, *E folmja e Skraparit*, «BUSHT, SShSh», 1958, nr. 1.
- Gjinari Jorgji**, *Të folmet e Myzeqesë*, «BUSHT, SShSh», 1958, nr. 4.
- Haebler Claus**, *Grammatik der albanischen Mundart von Salamis*. Wiesbaden, 1965.
- Hahn Georg von**, *Albanesische Studien*, Wien, 1854.
- Haxhihasani Qemal**, *Vëzhgime gjuhësore në krahinën e Lurës*, «BUSHT, SShSh», 1963, nr. 4.

- ILR**, *Istoria limbii române*, Volumul I (Limba latină). Editura Academiei Republicii Populare Române. București, 1965.
- Jespersen Otto**, *The Philosophy of Grammar*. (8th edition.). London, 1958.
- Jokl Norbert**, *Kristian Sandfeld, Balkanphilologien*, «Litteris», IV, 1927, nr. 3.
- Kostallari Androkli**, *Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme*, BSHSH, 1955, nr. 4.
- Lafe Emil**, *Trajtat e pjesores te Gjon Buzuku*, (Botuar në vëllimin Konferenca e parë e studimeve albanologjike, Tiranë, 1965).
- Lafe Emil**, *E folmja e Nikaj-Mërturit*, «Stud. fil.». 1964, nr. 3.
- Lambertz Max**, *Lehrgang des Albanischen*, III (Grammatik der albanischen Sprache). Leipzig, 1959.
- LR**, *Limba Romîna*.
- Meillet Antoine**, *Introduction à l'étude comparative des langues indo-européennes* (8^e édition), Paris, 1937.
- Meyer Gustav**, *Kurzgefasste albanesische Grammatik*, Leipzig, 1888.
- Moser-Philtsov Maria**, *Lehrbuch der neugriechischen Volkssprache*, München, 1964.
- Myderrizi Osman**, *Gramatika e re e shqipes*, Tiranë, 1944.
- Pancratz Arnold**, *Das Partizipium Perfekti Passivi und seine Anwendung im Rumänischen*, Balkan Archiv, I, 1925.
- Pedersen Holger**, *Bidrag til den albanesiske sproghistorie*, (Botuar në vëllimin Festschrift til Vilhelm Thomsen, 1894).
- Pedersen Holger**, *Albanesische Texte mit Glossar*, Leipzig, 1895.
- Pedersen Holger**, *Das albanesische Neutrum*, KZ (Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung auf dem gebiete der indogermanischen Sprachen, begründet von A. Kuhn), 34(1899):
- Pekmezi G**, *Grammatik der albanesischen Sprache*, Wien, 1908.
- Reinhold C. H. T**, *Noctes Pelasgicae*, Athenis, 1855.
- Sandfeld Kristian**, *Linguistique Balkanique*, Problèmes et résultats. Paris, 1930.
- Selishçev A. M**, *Sllavjanskoje naselenije v Albanii*, Sofija, 1931.
- Sheperi Ilia Dilo** *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe. sidomos e toskërishtes. Vlorë, 1927.*
- Tagliavini Carlo**, *Grammatica della lingua romena*, Heidelberg, 1923.
- Totoni Menella**, *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, «Stud. fil.» 1964, nr. 1, 2.
- Totoni Menella**, *E folmja e Zagorisë*, «BUSHT, SSHSH», 1962, nr. 1.
- Totoni Menella**, *Vëzhgime për të folmen e Muzinës*, «Stud. fil.». 1965, nr. 3.
- Totoni Menella**, *Vëzhgime rreth të folmes së qytetit të Gjirokastrës* «Stud. fil.». 1966, nr. 1.
- Thomaj Jani**, *E folmja e katundit Seman*, «BUSHT, SSHSH», 1961, nr. 3, 4.
- Weigand Gustav**, *Albanesische Grammatik im südgegischen Dialekt*, Leipzig, 1913.
- Xanoni Anton**, *Gramatika shqyp*, Shkodër, 1909.
- Xhuvani Aleksandër**, *Studime gjuhësore*, Tiranë, 1956.
- Xhuvani A. — Çabej E**, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1962.

VEPRAT NGA JANË NXJERRË SHEMBUJT PËR ILUSTRIM.

- Bardhi Frang**, *Dictionarium latino-epiroticum*, Romae, 1635.
Bogdani Pjetër, *Cuneus prophetarum de christo salvatore mundi... Patavii*, 1685.
Budi Pjetër, *Dottrina christiana* (bot. III), Roma, 1664.
Budi Pjetër, *Speculum confessionis*, Roma, 1621.
Budi Pjetër, *Rituale romanum*, Roma, 1621.
Buzuku Gj, *Meshari* (sipas transkribimit të Prof. E. Çabejt).
Çami Muhamet, *Erveheja* (botuar nga O. Myderrizi në BSHSH, 1957, nr. 1,
Dozon August, *Manuel de la langue chkipe ou albanaise*, Paris, 1879,
Filia Nikollë, *I krishteu i arbresh* (botuar nga M. Marchianô. Roma, 1911).
Frashëri Naim, *Istoria e Skënderbeut*, Bukuresht, 1898.
Frashëri Naim, *Dituritë*, Bukuresht, 1888.
Grigori (Gjirokastriti), *Dhiata e re...* Korfus, 1827.
Gjata Fatmir, *Përmbysja*, Tiranë, 1954.
Jarnik Jan Urban, *Přispevky ku poznani nareči albanskych*, V. Praze 1883.
Kadare Ismail, *Gjenerali i ushtërisë së vdekur*, Tiranë, 1963.
KPL, *Këngë popullore legjendare* (zgjedhur dhe pajisur me shënime nga Q. Haxhihasani). Botuar nga Instituti i Shkencave, Tiranë, 1955.
Kurti Donat, *Prralla*, Blë I, Shkodër, 1940. Blë II (bot. II). Shkodër, 1943.
Matrënga L, (C1) *Kopja 1 e dorëshkrimit*, botuar nga Matteo Sciambra në vëllimin La «Dottrina Cristiana» albaneze di Luca Matranga. 1964.
Mitko Thimi, *Bëleta shqypëtare*, (bot. II). Vjenë, 1924.
Mjeda Ndre, *Juvenilia*, Vjenë, 1917.
Musaraj Shevqet, *Para agimit*, Vëll. I, Tiranë, 1965. Vëll. II, Tiranë, 1966.
Musaraj Shevqet, *Isha unë Çobo Rrapushi*, Tiranë, 1960.
Noli Fan S, *Historia e Skënderbeut*, kryezotit të Arbërisë (1405-1468). Tiranë, 1962.
Pedersen Holger, *Albanesische Texte mit Glossar*, Leipzig, 1895.
Xoxa Jokov, *Lumi i vdekur*, Vëll. I, II, III. Tiranë, 1965.

Shënim. Shëmbujt për ilustrim janë marrë edhe nga artikujt e cituar të Jani Thomajt, Jorgji Gjinarit, Mehmet Çelikut, Menella Totonit dhe Qemal Haxhihasanit.

R é s u m é

LES NOMS DEVERBATIFS NEUTRES ET LES GROUPES
 DE MOTS A VALEUR VERBALE FORMES AVEC
 LEUR PARTICIPATION

Dans l'article en question, divisé en deux parties, sont analysés les noms déverbatifs neutres du type të folur-i-t / (= le parler) ainsi que les groupes de mots à valeur verbale, formés avec leur participation.

Dans la première partie, l'auteur analyse le mode de formation des

noms déverbatifs neutres et leur contenu sémantique. Après avoir fait ressortir que leur thème, si l'on élague l'article prépositif, coïncide avec celui du participe passé, l'auteur fait voir que le sens des noms en question ne s'écarte pas, en général, de celui des verbes correspondants. En albanais, les noms déverbatifs neutres peuvent avoir le sens transitif (actif et non-actif) et intransitif, en concordance avec le sens des verbes dont ils ont été formés. Au point de vue sémantique ces noms de l'albanais sont comparables aux noms d'action formés par l'infinitif dans de telles langues comme l'allemand, le français, l'italien, etc. Mais, si l'on tient compte aussi de leur structure, ils peuvent être comparés plutôt aux noms du type scris-ul du roumain.

La concordance albano-roumaine à ce point-ci va aussi outre. Tant en albanais qu'en roumain, les groupes de mots formés à l'aide des noms déverbatifs de ce type, précédés par la préposition për (pour l'albanais) et de (pour le roumain) sont grammaticalisés en assumant des valeurs sémantiques et fonctionnelles propres à l'infinitif.

L'auteur a exprimé l'avis que dans l'usage des noms déverbatifs neutres de sens notamment actif une part décisive a eu la disparition antique de l'infinitif ancien de l'albanais (la question de la disparition de l'infinitif l'auteur l'a traitée dans un article paru dans le N° 1 de notre organe).

En ce qui concerne la formation des noms d'origine participiale en albanais on doit distinguer deux types. L'un, qui est plus ancien, est celui qui se présente comme une substantivation du participe en-ë sans préarticulation et sans nul suffixe, comme pasë-a à côté de të pasun-i-të (= richesse) chez Buzuku. Il en est de même de dekë-a, lypë-a, etc. du guègue. Ce type n'est pas inconnu même dans le dialecte tosqe.

L'autre type, qui est devenu de beaucoup plus productif que le premier et qui doit être également assez ancien, est celui de la substantivation des participes préarticulés, c'est-à-dire adjectivés, de genre neutre, et, dans une phase postérieure, aussi du genre féminin. L'origine de ce type de substantivation doit être cherchée à un temps où la préarticulation des participes adjectivés était généralisée en albanais commun et quand le genre neutre était encore très vif dans la conscience des ancêtres des Albanais. Selon toute vraisemblance, ce temps doit être antérieur au commencement des contacts de l'albanais avec le slave, car au temps de la pénétration des slavismes en albanais le sens du neutre s'était sensiblement atténué dans cette langue. Cela est confirmé par le fait que du nombre des emprunts slaves de l'albanais on n'a pas des noms intégrés dans le genre neutre.

Sur l'ancienneté des noms déverbatifs neutres en albanais atteste également leur ample diffusion, parfaitement consolidée chez les anciens auteurs albanais (Buzuku, Budi et Matranga), lesquels à ce point-ci marquent un terminus ad quem de la plus grande vitalité de ce type de noms de l'albanais. Ce type de noms a été diffusé amplement dans tous les dialectes et sous-dialectes de l'albanais, y compris aussi ceux des Albanais de Grèce et d'Italie.

Une des conséquences de la vitalité antique de ce type de noms en albanais a été-aussi leur écart de plus en plus grand, au point de vue du sens, de la classe des adjectifs et leur intégration dans la classe des noms. Cela est confirmé, entre autres, aussi par le fait qu'en albanais on peut former des noms déverbatifs neutres mêmes sans l'existence d'adjectifs

déverbatifs (participiaux) non substantivés ou substantivés. C'est pourquoi, quoique à leurs débuts les noms déverbatifs en question fussent formés au moyen de la substantivation des participes adjectivés de genre neutre, avec le temps ils furent considérés comme des noms purement déverbatifs et, par conséquent, ils doivent être traités en tels sur le plan synchronique.

La deuxième partie de l'article est destinée à l'examen des groupes de mots grammaticalisés de type *për të punuar*, *me të ardhur* et *një të ardhur*, formés avec la participation des noms déverbatifs neutres. Au commencement il est fait ressortir l'univerbation verbale de ces groupes de mots naguère libres. A confirmation de cela sont invoqués les arguments suivants:

a) Du domaine de la morphologie: 1) Perte de la catégorie de défini de la part du nom déverbatif neutre; 2) Usage de ces groupes de mots dans les diathèses passivo-réflexives avec la particule pronominale *u* (comme: *për t'u larë*, *me t'u larë*, *një t'u larë*).

b) Du domaine de la syntaxe: 1) Impossibilité de la détermination du nom déverbatif dans ces groupes de mots par un adjectif ou un nom au génitif; 2) Usage de la particule négative *mos*, caractéristique pour les formes implicites du verbe; 3) Usage de ces groupes de mots avec des compléments directs et indirects, exprimés non seulement à l'aide de noms et de pronoms mais également à l'aide de formes brèves (= formes atones) de pronoms personnels, qui en albanais s'emploient seulement avec des formes verbales; 4) Outre les compléments d'objet et les compléments circonstanciels ces groupes de mots peuvent s'adjoindre aussi un sujet.

b) Au point de vue sémantique, les parties constituantes des groupes de mots en question ne sont pas usitées dans leurs sens habituels comme mots particuliers. Tout le groupe est usité, dans de tels cas, comme un seul mot à sens verbal, donc, comme une forme grammaticale périprastique de valeur verbale, qui indique une action ou bien un état en tant que processus.

Ensuite l'auteur analyse tour à tour les valeurs fonctionnelles des groupes de mots grammaticalisés du type *për të punuar*, *me të ardhur* et *një të ardhur*. Pour chacun de ces groupes de mots sont données brièvement les opinions exprimées par les divers chercheurs.

Sur le groupe grammaticalisé du type *për të punuar* l'auteur fait ressortir (l'illustrant par de nombreux exemples) les fonctions suivantes: 1) intentionnelle; 2) attributive; 3) prédicative (comme partie d'un prédicat composé formé avec la participation des verbes *jam* d'usage personnel ou impersonnel, *kam*, *bëhem*, *mbetet*, *jet* — ces deux derniers notamment à l'impersonnel; 4) en propositions subordonnées comparatives; 5) en fonction d'objet (quoique d'une façon restreinte); 6) en fonction de sujet (d'une façon limitée); 7) en constructions tautologiques du type *për të njohur*, *e njoh*; 8) (en *guëgue*) en fonction conditionnelle, après l'infinitif *me pasë*; 9) en tant que partie constituante du futur et du conditionnel, respectivement du futur dans le passé du type *kam për të ardhur*, *kisha për të ardhur*.

En se basant sur ces fonctions, caractéristiques à l'infinitif, l'auteur a exprimé l'opinion que le groupe de mots grammaticalisé du type *për të punuar* a assumé la valeur d'un infinitif avec fonctions syntaxiques limitées, puisque dans le fonction de sujet et d'objet le

groupe en question a un usage circonscrit. Cette opinion il l'a exprimée aussi antérieurement dans une communication tenue devant la Première Conférence des Etudes Albanologiques (1962) ainsi que dans un article paru dans les «*Studime filologjike*», N^o. 1, 1969.

Pour le groupe grammaticalisé du type *me të ardhur*, l'auteur a fait ressortir qu'il peut être catégorisé comme un groupe de mots à valeur participiale. Le sens temporel de celui-ci est conditionné par le sens temporel du verbe de la proposition régente. Lorsque cette dernière est au passé simple ou bien au présent historique, alors l'action exprimée par le groupe en question est une action concrète particulière (allemand *einzelnen*), qui a pris fin dans le passé; dans ce cas on peut lui substituer la forme correspondante du passé simple, précédée par une des conjonctions de subordination temporelle: *sa*, *posa*, *sapo*. Lorsque le verbe de la proposition régente est au futur ou dans le mode impératif ou bien au conjonctif (de sens impératif), alors le sens temporel du groupe de mots en question se réfère à l'avenir et on peut lui substituer aussi la forme correspondante du conjonctif présent, précédée par une des conjonctions sus-mentionnées.

Aussi le groupe grammaticalisé du type *një të ardhur* peut être catégorisé comme un groupe de valeur participiale. Il peut être utilisé:

1) Avec la valeur d'une proposition indépendante, lorsque les constructions de ce type sont coordonnées en séquelle à l'aide de la conjonction copulative *e* (*edhe*, *dhe*) ou bien de façon asyndète.

2) Avec la même valeur comme sur le point 1 sont usitées les constructions de ce type même lorsqu'elles sont coordonnées avec une proposition indépendante, dont le prédicat est un verbe au passé simple.

3) Avec la valeur d'une proposition dépendante (comme le groupe de mots du type: *me të ardhur*), lorsque le groupe en question satisfait au sens d'une proposition, dont le prédicat est un verbe au passé simple.

Dans les parlers guègues, où le sens du neutre a été sensiblement atténué et on a substitué à la forme neutre des noms déverbatifs la forme féminine, dans les groupes du type *me të ardhur* et *një të ardhur*, le nom déverbatif est usité plutôt sous la forme du féminin. Même, dans quelques parlers guègue, avec la valeur du groupe de mots du type *me të ardhur*, est usitée la forme de l'accusatif défini au singulier du nom déverbatif de genre neutre.

A la fin de son article, l'auteur a exprimé quelque opinion sur la formation des groupes de mots grammaticalisés en question.

Pour ce qui est de la concordance du type *për të bërë* de l'albanais et du type de *făcut* du roumain, l'auteur croit qu'on doit les envisager comme développements parallèles, formés qu'ils sont à une époque où n'existaient pas des contacts directs entre l'albanais et le roumain.

Pour la concordance entre le groupe de mots du type *një të ardhur* de l'albanais et les constructions correspondantes du macédonno-bulgare et de l'aroumain, que Sandfeld (Ling. Balk. 122 sq.) range parmi les concordances balkaniques, dont «il est difficile de fixer le point de départ», l'auteur de l'article croit que le point de départ dans ce cas doit être cherché en albanais pour les raisons suivantes: 1) Ce groupe de mots de valeur verbale est de l'albanais tout entier, donc, il doit être relativement ancien. 2) Le fait que les groupes de mots correspondants sont rencontrés dans le seul macédonno-roumain et l'aroumain, mais non dans le bulgare vrai et propre et dans le dacoroumain, milite parfaitement en faveur de l'âge

assez récent de ces constructions en macédono-bulgare et aroumain. 3) Les deux raisons des points 1, 2 ainsi que le fait que le macédono-bulgare et l'aroumain ont été en contact continu avec l'albanais, font opiner que ce type de constructions ait été calqué d'après le modèle de l'albanais par le macédono-bulgare et l'aroumain.

Pour ce qui est de la concordance invoquée par Sandfeld (op. cit., 124) entre la construction albanaise du type *me të dëgjuar* et la construction grecque du type *μὲ το παλιόμα του . . .*, l'auteur Demiraj croit que dans ce cas on n'a pas affaire au même type de construction. La construction grecque n'a pas pris des traits grammaticaux verbaux comme ceux de la construction albanaise (v. plus haut).

La grammaticalisation des groupes de mots du type *për të punuar*, *me të ardhur* et *një të ardhur* représente des développements intérieurs de l'albanais. Ce type de grammaticalisation est relativement plus jeune que celui des groupes de mots du type *me qenë*, *pa qenë*, *duke qenë*, dont le deuxième élément a été un participe substantivé: